



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.23

18 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 235 datë 18.2.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve, për bujqësinë dhe ushqimin.....	695
Ligj nr.10 236 datë 18.2.2010	Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike	711

LIGJ
Nr.10 235, datë 18.2.2010

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN NDËRKOMBËTAR
PËR BURIMET GJENETIKE TË BIMËVE, PËR BUJQËSINË DHE USHQIMIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve, për bujqësinë dhe ushqimin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6456, datë 9.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**TRAKTAT NDËRKOMBËTAR
PËR BURIMET GJENETIKE TË BIMËVE PËR BUJQËSINË DHE USHQIMIN**

Preambula

Palët kontraktuese,

të bindura për natyrën e veçantë të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, tipareve të tyre të dallueshme dhe problemeve që kanë nevojë për zgjidhje të dallueshme;

të alarmuara nga erozioni i vazhdueshëm i këtyre burimeve;

të vetëdijshme që burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin janë një shqetësim i përbashkët për të gjitha vendet, pasi të gjitha vendet varen shumë tek burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin që e kanë origjinën gjatë;

duke e ditur se konservimi, eksplorimi, mbledhja, karakterizimi, vlerësimi dhe dokumentimi i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin janë thelbësore për të plotësuar objektivat e Deklaratës së Romës për sigurinë e ushqimit dhe planit të veprimit të samitit botëror të ushqimit dhe për zhvillimin bujqësor të qëndrueshëm për këtë brez dhe për brezat që do të vijnë, dhe se kapaciteti i vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion për të ndërmarrë detyra të tilla duhet të përforcohet urgjent;

duke vënë re se plani botëror i veprimit për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin është një kuadër i pranuar ndërkombëtarisht për aktivitete të tilla;

duke njohur më tej se burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin janë lëndë e parë e domosdoshme për përmirësimin gjenetik të bimëve, ose nëpërmjet përzgjedhjes nga fermerët nëpërmjet përmirësimit klasik ose bioteknologjive moderne, dhe janë thelbësore për përshtatjen ndaj ndryshimeve të paparashikuara mjedisore dhe nevojave të njerëzve në të ardhmen;

duke afirmuar se kontributet e fermerëve në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen në të gjitha pjesët e botës, në veçanti ato në qendra të origjinës dhe diversitetit, në konservimin, përmirësimin dhe bërjen e këtyre shërbimeve të disponueshme përbëjnë bazën e të drejtave të fermerëve;

duke afirmuar edhe se të drejtat e njohura në këtë traktat për të ruajtur, përdorur, shkëmbyer, dhe për të shitur fara të ruajtura nga fermerët dhe materiale të tjera të shumimit, dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje në lidhje me përdorimin e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, dhe në ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë prej tyre, janë thelbësore për respektimin e të drejtave të fermerëve, si dhe për nxitjen e të drejtave të fermerëve në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare;

duke njohur se ky traktat dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që lidhen me këtë traktat duhet të jenë mbështetëse për sa i përket bujqësisë së qëndrueshme dhe sigurisë ushqimore;

duke afirmuar se asgjë në këtë traktat nuk do të interpretohet thjesht si nënkuptim i ndonjë ndryshimi në të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare;

duke kuptuar se ky dokument nuk ka synim të krijojë një hierarki ndërmjet këtij traktati dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare;

të vetëdijshme që çështjet që lidhen me menaxhimin e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin janë në një pikë takimi ndërmjet bujqësisë, mjedisit dhe tregtisë dhe të bindur që duhet të ketë sinergji ndërmjet këtyre sektorëve;

të vetëdijshme për përgjegjësinë e tyre për brezat e mëparshëm dhe të ardhshëm për të ruajtur diversitetin e botës, për sa u përket burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin;

duke njohur që, në ushtrimin e të drejtave të tyre sovrane mbi burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, shtetet mund të përfitojnë bashkërisht nga krijimi i një sistemi efektiv shumëpalësh për një akses të lehtësuar në një përzgjedhje të negociuar të këtyre burimeve dhe për një ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga përdorimi i tyre; dhe

duke dëshiruar të bien dakord për një marrëveshje ndërkombëtare në kuadrin e Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara, më poshtë FAO, sipas nenit XIV të Kushtetutës së FAO-s,

palët kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I HYRJE

Neni 1 Objektivat

1.1 Objektivat e këtij traktati janë ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin dhe ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve që dalin nga përdorimi i tyre, në përputhje me Konventën për diversitetin biologjik për një bujqësi të qëndrueshme dhe për sigurinë ushqimore.

1.2 Këto objektiva do të realizohen duke e lidhur ngushtë këtë traktat me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, dhe Konventën për diversitetin biologjik.

Neni 2 Përdorimi i termave

Për qëllime të këtij traktati, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e dhëna më poshtë. Këto përkufizime nuk synojnë të mbulojnë tregtinë e produkteve:

“Ruajtja *in situ*” është ruajtja e ekosistemeve dhe e habitateve natyrore dhe mirëmbajtja dhe riaftësimi i popullatave të vlefshme të specieve në ambientet e tyre natyrore dhe, në rast të specieve bimore të rritura në kushte shtëpiake ose të kultivuara, në ambiente në të cilat ato kanë zhvilluar tiparet e tyre dalluese.

“Ruajtja *ex situ*” nënkupton ruajtjen e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin jashtë mjedisit të tyre natyror.

“Burimet gjenetike bimore për bujqësinë dhe ushqimin” nënkupton çdo material gjenetik me origjinë bimore me vlerë aktuale ose potenciale për bujqësinë dhe ushqimin.

“Material gjenetik” nënkupton çdo material me origjinë bimore, duke përfshirë materialet riprodhuese dhe vegjetative që shtohen, që përmbajnë njësi funksionale të trashëgimisë.

“Variatet” nënkupton një grup bimor brenda një taksoni të vetëm botanik të nivelit më të ulët të njohur, i përcaktuar nga shprehja e riprodhueshme e karakteristikave të tij të dallueshme ose e karakteristikave të tjera gjenetike.

“Koleksionimi *ex situ*” nënkupton një koleksion të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin jashtë mjedisit të tyre natyror.

“Qendra e origjinës” nënkupton zonën gjeografike ku një specie bimore e kultivuar ose e egër, zhvilloi për herë të parë tiparet e saj të dallueshme.

“Qendra e diversitetit të bimëve” nënkupton një zonë gjeografike që përmban një nivel të lartë të diversiteti gjenetik për speciet e bimëve në kushtet in situ.

Neni 3 Qëllimi

Ky traktat lidhet me burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

PJESA II DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 4 Detyrime të përgjithshme

Çdo palë kontraktuese siguron përputhshmërinë me ligjet, rregulloret dhe procedurat e saj me detyrimet, siç parashikohen në këtë traktat.

Neni 5 **Ruajtja, eksplorimi, mbledhja, karakterizimi, vlerësimi dhe dokumentimi i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin**

5.1 Çdo palë kontraktuese, kur lejohet nga legjislacioni kombëtar, dhe në bashkëpunim me palët e tjera kontraktuese, dhe kur duhet, promovon një qasje të integruar për eksplorimin, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për ushqimin dhe bujqësisë, dhe në veçanti, sipas rastit:

a) vrojtojnë dhe bëjnë inventarin e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, duke marrë parasysh statusin dhe nivelin e ndryshimit në popullatat ekzistuese, duke përfshirë dhe përdorimin potencial, dhe, sipas mundësive, vlerësojnë kërcënimet që u kanosen këtyre popullatave;

b) nxisin mbledhjen e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin dhe informacionin përkatës që lidhet me këto burime gjenetike të bimëve që janë të kërcënuara ose janë në përdorim potencial;

c) nxisin ose mbështesin, në mënyrën e duhur, përpjekjet e fermerëve dhe komuniteteve lokale për të menaxhuar dhe për të ruajtur burime gjenetike të bimëve të tyre për bujqësinë dhe ushqimin në fermë;

d) nxisin konservimin *in situ* të llojeve të egra të bimëve dhe vetë bimëve të egra për prodhimin e ushqimit, duke përfshirë dhe zonat e mbrojtura, duke mbështetur, ndër të tjera, përpjekjet e komuniteteve vendase dhe lokale;

e) bashkëpunojnë për të nxitur zhvillimin e një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të konservimit *ex situ*, duke i kushtuar vëmendje nevojës për një dokumentacion të duhur, karakterizim, rigjenerim dhe vlerësim, dhe për të nxitur zhvillimin dhe transferimin e teknologjive të përshtatshme për këtë qëllim, me synim përmirësimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për ushqime dhe bujqësi;

f) monitorojnë ruajtjen e zbatueshmërisë, shkallën e ndryshimit dhe integritetin gjenetik të koleksioneve të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

5.2. Palët kontraktuese, sipas nevojës, marrin masa për të minimizuar ose, nëse është e mundur, për të eliminuar kërcënimet ndaj burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

Neni 6

Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve gjenetike të bimëve

6.1 Palët kontraktuese zhvillojnë dhe ruajnë politika dhe masa ligjore të duhura për promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

6.2 Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin mund të përfshijë masa të tilla si:

a) ndjekja e politikave të drejta të bujqësisë, që nxisin, sipas nevojës, zhvillimin e sistemeve të ndryshme bujqësore që rrisin përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik dhe burimeve të tjera natyrore;

b) forcimi i kërkimit që nxit dhe ruan diversitetin biologjik duke maksimizuar ndryshimin intra dhe inter specifik për përfitime të fermerëve, në veçanti të atyre që gjenerojnë dhe përdorin varietetet e tyre dhe zbatojnë parimet ekologjike në ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe në luftën kundër sëmundjeve, barërave të këqija dhe insekteve të dëmshme;

c) nxitja, sipas nevojës, e përpjekjeve për përmirësimin gjenetik të bimëve, të cilat, me pjesëmarrjen e fermerëve, në veçanti në vendet në zhvillim, forcojnë kapacitetin për të zhvilluar varietete, në veçanti të përshtatura me kushtet sociale, ekonomike dhe ekologjike, duke përfshirë dhe zonat margjinale;

d) zgjerimi i bazës gjenetike të bimëve dhe rritja e gamës së diversitetit gjenetik që është i disponueshëm për fermerët;

e) nxitja, sipas nevojës, e përdorimit të gjerë të bimëve lokale dhe atyre të përshtatura, varietetet dhe speciet e nënvlerësuara;

f) mbështetja, sipas nevojës, e përdorimit të gjerë të diversitetit të varieteteve dhe specieve të menaxhimit në fermë, konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të bimëve dhe krijimi i lidhjeve të forta për përmirësimin e bimëve dhe zhvillimin bujqësor, në mënyrë që të ulët cenueshmëria e bimëve dhe erozioni gjenetik dhe promovimi i një prodhimi ushqimor botëror të rritur me zhvillim të qëndrueshëm; dhe

g) rishikimi dhe, sipas nevojës, përshtatja e strategjive dhe rregulloreve të përmirësimit të bimëve në lidhje me daljen e varieteteve dhe shpërndarjen e farërave.

Neni 7

Angazhimet kombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

7.1 Çdo palë kontraktuese, sipas nevojës, do të integrojë në politikat dhe programet e zhvillimit bujqësor dhe rural aktivitetet që i referohen nenit 5 dhe 6, dhe bashkëpunon me palët kontraktuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet FAO-s dhe organizatave të tjera përkatëse ndërkombëtare për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

7.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar, në veçanti, do të drejtohet në:

a) krijimin ose forcimin e aftësive të vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion, në lidhje me ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin;

b) rritjen e aktiviteteve ndërkombëtare për të nxitur konservimin, vlerësimin, dokumentacionin, rritjen gjenetike, përmirësimin e bimëve, shtimin e farërave; dhe ndarjen, duke ofruar akses dhe duke shkëmbyer në përputhje me pjesën IV, burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, informacionin dhe teknologjitë e nevojshme;

c) ruajtjen dhe forcimin e rregullimeve institucionale të parashikuara në pjesën V; dhe

d) zbatimin e një strategjie financimi që përcaktohet në nenin 18.

Neni 8

Ndihma teknike

Palët kontraktuese bien dakord për të nxitur ofrimin e ndihmës teknike për palët kontraktuese, në veçanti për ato palë që janë vende në zhvillim ose vende me ekonomi në tranzicion, ose në mënyrë bilaterale ose nëpërmjet organizatave përkatëse ndërkombëtare, me objektivin e lehtësimit të zbatimit të këtij traktati.

PJESA III

TË DREJTAT E FERMERËVE

Neni 9

Të drejtat e fermerëve

9.1 Palët kontraktuese njohin kontributin e madh të dhënë dhe do që të vazhdojnë të japin komunitetet lokale dhe vendase dhe të fermerëve të të gjitha rajoneve të botës, në veçanti të komuniteteve të qendrave të origjinës dhe diverstetit të bimëve për ruajtjen dhe zhvillimin e burimeve gjenetike të bimëve që përbëjnë bazën e prodhimit ushqimor dhe bujqësor në të gjithë botën.

9.2 Palët kontraktuese bien dakord se përgjegjësia për realizimin e të drejtave të fermerëve, përdërisa ato lidhen me burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, u takon qeverive kombëtare. Në përputhje me nevojat dhe përparësitë e saj, çdo palë kontraktuese, sipas nevojës, dhe në varësi të legjislacionit kombëtar, merr masa për të mbrojtur dhe për të nxitur të drejtat e fermerëve, duke përfshirë:

a) mbrojtjen e njohurive tradicionale që lidhen me burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin;

b) të drejtën e barazisë për të marrë pjesë në ndarjen e përfitimeve që dalin nga përdorimi i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin; dhe

c) të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje, në nivel kombëtar, për çështje që lidhen me ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

9.3 Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet si kufizim i të drejtave të fermerëve për të ruajtur, përdorur, shkëmbyer dhe shitur farëra/materialin shumues, të ruajtur në fermë sipas legjislacionit të brendshëm dhe në mënyrën e duhur.

PJESA IV

SISTEMI SHUMËPALËSH I AKSESIT DHE I NDARJES SË PËRFITIMEVE

Neni 10

Sistemi shumëpalësh i së drejtës dhe i ndarjes së përfitimeve

10.1 Në marrëdhëniet e tyre me shtetet e tjera, palët kontraktuese njohin të drejtat sovrane të shteteve mbi burimet gjenetike të bimëve të tyre për bujqësinë dhe ushqimin, duke përfshirë se autoriteti për përcaktimin e së drejtës për këto burime u përket qeverive kombëtare dhe është subjekt i legjislacionit kombëtar.

10.2 Në ushtrimin e të drejtave të tyre sovrane, palët kontraktuese bien dakord të krijojnë një sistem shumëpalësh, që është efikas, efektiv dhe transparent, si për të lehtësuar akses për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, dhe për të ndarë, në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë, përfitimet që dalin nga shfrytëzimi i këtyre burimeve mbi një bazë plotësuese dhe përforcuese të ndërsjellë.

Neni 11

Sigurimi i sistemit shumëpalësh

11.1 Në mbështetje të objektivave të konservimit dhe të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin dhe ndarjes së drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga përdorimi i tyre siç jepet në nenin 1, sistemi shumëpalësh mbulon burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin të dhëna në listë në shtojcën I, të përcaktuar sipas kriterëve të sigurisë ushqimore dhe të ndërvlerësive.

11.2 Sistemi shumëpalësh, siç përkufizohet në nenin 11.1, përfshin të gjitha burimet gjenetike të bimëve për ushqime dhe bujqësinë të dhëna në listë në shtojcën I që janë nën menaxhimin dhe kontrollin e palëve kontraktuese dhe në zotërim publik. Me qëllimin e plotësimit të sigurimit të plotë të mundshëm të sistemit shumëpalësh, palët kontraktuese ftojnë të gjithë mbajtësit e tjerë të burimeve gjenetike për bujqësinë dhe ushqimin të dhëna në shtojcën I, të përfshijnë burimet gjenetike të këtyre bimëve për ushqime dhe bujqësi në sistemin shumëpalësh.

11.3 Palët kontraktuese bien dakord gjithashtu të marrin masat e nevojshme për të inkurajuar personat fizikë dhe juridikë, brenda juridiksionit të tyre, të cilët mbajnë burime gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin të dhëna në shtojcën I për të përfshirë burime të tilla gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë në sistemin shumëpalësh.

11.4 Brenda dy vitesh nga hyrja në fuqi e këtij traktati, organi drejtues vlerëson progresin në përfshirjen e burimeve gjenetike të bimëve për ushqim dhe bujqësi që përmenden në paragrafin 11.3 të sistemit shumëpalësh. Pas këtij vlerësimi, organi drejtues vendos nëse aksesin do të vazhdojë të lehtësohet për ata persona fizikë dhe juridikë të cilëve u referohet paragrafi 11.3, të cilët nuk kanë përfshirë burimet gjenetike të këtyre bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në sistemin shumëpalësh, ose të marrë masa të tjera sipas nevojës.

11.5 Sistemi shumëpalësh përfshin dhe burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, të dhëna në listë në shtojcën I dhe të mbajtura në koleksionet *ex situ* të Qendrave Ndërkombëtare të Kërkimit Bujqësor të Grupit Konsultativ për Kërkime Ndërkombëtare Bujqësore (CGIAR), siç parashikohet në nenin 15.1a, dhe në institucione të tjera ndërkombëtare, në përputhje me nenin 15.5.

Neni 12

Akses i lehtësuar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin brenda sistemit shumëpalësh

12.1 Palët kontraktuese bien dakord se aksesin i lehtësuar për burimet gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë për sistemin shumëpalësh, siç përkufizohet në nenin 11, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij traktati.

12.2 Palët kontraktuese bien dakord të marrin masat e nevojshme ligjore ose masa të tjera për të dhënë një akses të tillë për palët e tjera kontraktuese përmes sistemit shumëpalësh. Për këtë qëllim, një akses i tillë do t'u jepet personave fizikë dhe juridikë nën juridiksionin e çdo pale kontraktuese, subjekt i dispozitave të nenit 11.4.

12.3 Një akses i tillë do të jepet në përputhje me kushtet e dhëna më poshtë:

a) Aksesin do të jepet vetëm për qëllim të përdorimit dhe konservimit për kërkim, përmirësim gjenetik apo trajnim për ushqime dhe bujqësi, me kusht që një qëllim i tillë të mos përfshijë përdorime kimikatesh, farmaceutike dhe/ose përdorime të tjera joushqimore/industriale. Në rastin e prodhimeve me shumë përdorime (ushqimore dhe joushqimore), rëndësia e tyre për sigurinë ushqimore do të jetë përcaktuese për përfshirjen e tyre në sistemin shumëpalësh dhe disponueshmërinë e aksesit të lehtësuar.

b) Aksesit do të jepet me shpejtësi, pa nevojën për të gjurmuar mostra individuale dhe pa pagesë, ose kur vendoset një tarifë, ajo nuk duhet ta kalojë koston minimale të përfshirë.

c) Të gjitha të dhënat e disponueshme të pasaportave, dhe në varësi të ligjit të aplikueshëm, çdo informacion tjetër i disponueshëm në lidhje me to dhe i një natyre përshkruese jokonfidenciale, do të bëhet i disponueshëm me burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

d) Marrësit nuk do të pretendojnë asnjë pronësi intelektuale ose të drejta të tjera që kufizojnë aksesin e lehtësuar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, ose pjesët e tyre gjenetike ose komponentët në formën e marrë nga sistemi shumëpalësh.

e) Aksesit për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin nën zhvillim, duke përfshirë materialin që krijohet nga fermerët, do të jetë në të drejtë të krijuesit të tyre, gjatë periudhës së krijimit.

f) Aksesit për burimet gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë e mbrojtur nga të drejta të tjera intelektuale dhe të pronësisë do të jenë në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe me ligjet përkatëse kombëtare.

g) Burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin të mbrojtura nga të drejta intelektuale të tjera të pronësisë do të jenë në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe me ligjet kombëtare përkatëse.

h) Pa cenuar dispozitat e tjera në këtë nen, palët kontraktuese bien dakord se aksesit për burime gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin të gjetura në kushte *in situ* do të jepen në përputhje me legjislacionin kombëtar ose, në mungesë të një legjislacioni të tillë, në përputhje me standarde të tilla, siç mund të përcaktohet nga organi drejtues.

12.4 Për këtë qëllim, aksesit i lehtësuar, në përputhje me nenet 12.2 dhe 12.3 më lart, do të jepen në përputhje me një marrëveshje standarde transferimi materiali (MTA), e cila do të miratohet nga organi drejtues dhe përmban dispozitat e neneve 12.3 “a”, “d” dhe “g”, si dhe dispozitat e ndarjes së përfitimeve të parashikuara në nenin 13.2(ii) dhe dispozita të tjera përkatëse të këtij traktati, dhe dispozitën që marrësi i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin kërkon që të aplikohen kushtet e MTA-së për transferimin e burimeve gjenetike të bimëve për ushqime dhe bujqësinë për një tjetër person ose subjekt, si dhe çdo transferim tjetër pasues i këtyre burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

12.5 Palët kontraktuese sigurojnë se është e disponueshme mundësia për të kërkuar tërheqje, në përputhje me kërkesat juridike të aplikueshme, sipas sistemeve ligjore, në rast të mosmarrëveshjeve kontraktuale që dalin në marrëveshje (MTA), duke njohur se detyrimet që dalin nga marrëveshjet e tilla u takojnë ekskluzivisht palëve të këtyre marrëveshjeve.

12.6 Në situata të fatkeqësive emergjente, palët kontraktuese bien dakord të ofrojnë akses të lehtësuar për burimet e nevojshme gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në sistemin shumëpalësh për qëllime të kontributit për rivendosjen e sistemeve bujqësore, në përputhje me koordinatorët e ndihmës ndaj fatkeqësive.

Neni 13

Ndarja e përfitimeve në sistemin shumëpalësh

13.1 Palët kontraktuese njohin që aksesit i lehtësuar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin që përfshihen në sistemin shumëpalësh në vetvete përbën një përfitim të madh të sistemit shumëpalësh dhe bien dakord se përfitimet që dalin prej tij ndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në përputhje me dispozitat e këtij neni.

13.2 Palët kontraktuese bien dakord se përfitimet që dalin nga përdorimi, duke përfshirë dhe atë tregtar, të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin sipas sistemit shumëpalësh, do të ndahen drejt dhe në mënyrë të barabartë nëpërmjet mekanizmave të mëposhtëm: shkëmbimit të teknologjisë, ndërtimit të kapacitetit dhe ndarjen e përfitimeve që dalin nga komercializimi, duke marrë parasysh zonat e aktiviteteve parësore në planin global të veprimit, nën udhëzimin e organit drejtues.

a) Shkëmbimi i informacionit:

Palët kontraktuese bien dakord të bëjnë të disponueshëm informacionin, i cili, ndër të tjera, përfshin katalogë dhe inventarë, informacion mbi teknologjitë, rezultate të kërkimeve shkencore dhe social-ekonomike, duke përfshirë karakterizimin, vlerësimin dhe përdorimin, duke pasur parasysh ato burime gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë që parashikohen në sistemin shumëpalësh. Një informacion i tillë do të bëhet i disponueshëm në rastet kur ai nuk është i rezervuar, është subjekt i ligjit të aplikueshëm dhe në përputhje me kapacitetet lokale. Një informacion i tillë do t'u bëhet i disponueshëm të gjitha palëve kontraktuese të këtij traktati përmes sistemit të informacionit, të parashikuar në nenin 17.

b) Aksesi dhe transferimi i teknologjisë

i) Palët kontraktuese marrin përsipër të ofrojnë dhe/ose lehtësojnë akses në teknologjitë për konservimin, karakterizimin, vlerësimin dhe përdorimin e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin të cilat janë në sistemin shumëpalësh. Duke njohur se disa teknologji mund të transferohen me atë të materialit gjenetik, palët kontraktuese ofrojnë dhe/ose lehtësojnë akses për teknologji të tilla dhe material gjenetik që është nën sistemin shumëpalësh dhe për varietetet e përmirësuara dhe materiale gjenetike të krijuara me anë të përdorimit të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin sipas sistemit shumëpalësh, në përputhje me dispozitat e nenit 12. Aksesi në këto teknologji, varietetet e përmirësuara dhe materiali gjenetik do të ofrohen dhe/ose lehtësohen ndërsa respektohen të drejtat e aplikueshme të pronësisë dhe lejet e aksesit, dhe në përputhje me kapacitetet kombëtare.

ii) Aksesi dhe transferimi i teknologjisë në vende të tjera, në veçanti në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion do të kryhet nëpërmjet një grupi masash, të tilla si: krijimi dhe matja, dhe pjesëmarrja në grupe tematike me bazë prodhimesh për përdorimin e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, të gjitha llojet e partneritetit në kërkim dhe zhvillim dhe në kompanitë e përbashkëta tregtare në lidhje me materialin e marrë, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe aksesi efektiv i lehtësirave të kërkimit.

iii) Aksesi dhe transferimi i teknologjisë që i referohet pikës (i) dhe (ii) më lart, duke përfshirë dhe teknologjinë e mbrojtur nga të drejtat e pronësisë intelektuale, për vendet në zhvillim që janë palë kontraktuese, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, dhe vendet me ekonomi në tranzicion, të cilat do të furnizohen dhe/ose lehtësohen sipas kushteve të drejta dhe më të favorshme të mundshme, në veçanti në rast të teknologjive për përdorim në konservim dhe teknologjive për përfitim të fermerëve në vendet e zhvilluara, në veçanti të vendeve më pak të zhvilluara, dhe vendeve me ekonomi në tranzicion, duke përfshirë dhe kushte koncensionare dhe preferenciale ku është rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë, ndër të tjera, nëpërmjet partneriteteve në kërkim dhe zhvillim nën sistemin shumëpalësh. Një akses dhe transferim i tillë do të ofrohet me kushte të cilat njohin dhe janë në përputhje me mbrojtjen e përshtatshme dhe efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale.

c) Ndërtimi i kapacitetit

Duke marrë parasysh nevojat e vendeve në zhvillim dhe të vendeve me ekonomi në tranzicion, siç shprehet nëpërmjet përparësisë që i japin ndërtimit të kapacitetit në burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në planet dhe programet e tyre, kur përcaktohen, për sa u përket atyre burimeve gjenetike bimore për ushqime dhe bujqësi të mbuluara nga sistemi shumëpalësh, palët kontraktuese bien dakord t'i japin përparësi: i) krijimit dhe/ose forcimit të programeve për arsimim shkencor dhe teknik dhe trajnim në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin; ii) zhvillimit dhe forcimit të ambienteve për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, në veçanti në vendet e zhvilluara, dhe në vendet me ekonomitë në tranzicion; dhe iii) duke kryer mundësisht kërkim shkencor, dhe, aty ku është e mundur, në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion, në bashkëpunim me institucionet e ekonomive të tilla, t'i japin përparësi dhe zhvillim kapacitetesh për një kërkim të tillë në fusha ku ato nevojiten.

d) Ndarja e përfitimeve monetare dhe e përfitimeve të tjera të komercializimit:

i) Palët kontraktuese bien dakord, sipas sistemit shumëpalësh, të marrin masa në mënyrë që të arrijnë ndarjen e përfitimeve tregtare, nëpërmjet përfshirjes së sektorëve privatë dhe publikë në aktivitetet e identifikuara në këtë nen, me anë të partneriteteve dhe bashkëpunimit, duke u përfshirë me sektorin privat në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion, në kërkim dhe në zhvillimin e teknologjisë.

ii) Palët kontraktuese bien dakord që marrëveshja standarde e transferimit material, së cilës i referohet neni 12.4, përfshin një kërkesë që një marrës që tregton një produkt që është një burim gjenetik bimor për bujqësinë dhe ushqimin dhe që përshin material të aksesueshëm nga sistemi shumëpalësh, do t'i paguajë mekanizmit që referohet në nenin 19.3 f një pjesë të barabartë të përfitimeve që dalin nga tregtimi i këtij produkti, në përjashtim të rasteve kur një produkt i tillë është i disponueshëm për të tjerët pa kufizime për kërkim apo shtim, dhe në këtë rast marrësi që bën tregtimin inkurajohet të bëjë një pagesë të tillë.

Organi drejtues, në takimin e tij të parë, përcakton nivelin, formën dhe mënyrën e pagesës, në përputhje me praktikën tregtare. Organi drejtues mund të vendosë të përcaktojë nivele të ndryshme pagese për kategori të ndryshme të marrësve që tregtojnë produkte të tilla: ato mund të vendosin gjithashtu dhe për nevojën për të përjashtuar nga pagesa të tilla fermerët e vegjël në vendet në zhvillim dhe në vendet me ekonomitë në tranzicion. Organi drejtues, herë pas here, mund të rishikojë nivelet e pagesës me qëllimin e arritjes së ndarjes së drejtë dhe të barabartë të përfitimeve, dhe mund të vlerësojë, brenda një periudhe prej pesë vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij traktati, nëse kërkesat për pagesë të detyrueshme në marrëveshje zbatohen dhe në rastet kur produkte të tilla të komercializuara janë të disponueshme pa kufizime ndaj të tjerëve për kërkim ose shtim të mëtejshëm.

13.3 Palët kontraktuese bien dakord se përfitimet që dalin nga përdorimi i burimeve gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë që ndahen sipas sistemit shumëpalësh rrjedhin fillimisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, për fermerët në të gjitha vendet, në veçanti në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomitë në tranzicion, të cilët konservojnë dhe përdorin në mënyrë të qëndrueshme burimet gjenetike të bimëve për ushqime dhe bujqësi.

13.4 Organi drejtues, në takimin e parë, shqyrton politika dhe kritere përkatëse për ndihmë specifike sipas strategjisë të financimit të rënë dakord sipas nenit 18 për ruajtjen e burimeve gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësitë në vendet në zhvillim, dhe vendet me ekonomi në tranzicion, kontributi i të cilave për diversitetin e burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në sistemin shumëpalësh është domethënës dhe/ose ka nevoja të veçanta.

13.5 Palët kontraktuese njohin se aftësia për të zbatuar plotësisht planin global të veprimit, në veçanti të vendeve në zhvillim dhe të vendeve me ekonomi në tranzicion, varet shumë te zbatimi efektiv të këtij neni dhe strategjia financuese e parashikuar në nenin 18.

13.6 Palët kontraktuese shqyrtojnë modalitetet e një strategjie të kontributeve vullnetare të ndarjes së përfitimeve me anë të të cilave industritë e përpunimit ushqimor që përfitojnë nga burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin kontribuojnë në sistemin shumëpalësh.

PJESA V KOMPONENTËT MBËSHTETËS

Neni 14 **Plani global i veprimit**

Duke njohur se plani global i veprimit për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin është i rëndësishëm për këtë traktat, palët kontraktuese do të nxisin zbatimin e tij efektiv, duke përfshirë nëpërmjet veprimeve kombëtare dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunimin ndërkombëtar për të ofruar një kuadër koherent, ndër të tjera, për ndërtimin e kapaciteteve, transferimin e teknologjisë dhe shkëmbimin e informacionit, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 13.

Koleksionet *ex - situ* të burimeve gjenetike bimore për bujqësinë dhe ushqimin që mbahen në qendrat ndërkombëtare kërkimore bujqësore të Grupit Konsultativ për Kërkimin Bujqësor Ndërkombëtar dhe institucione të tjera ndërkombëtare

15.1 Palët kontraktuese njohin rëndësinë e këtij traktati për koleksionet *ex - situ* të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, të mbajtura në besim nga Qendrat Ndërkombëtare Kërkimore Bujqësore (IARC) të Grupit Konsultativ për Kërkim Ndërkombëtar Bujqësor (CGIAR). Palët kontraktuese i bëjnë thirrje IARC-ve të nënshkruajnë marrëveshje me organin drejtues në lidhje me koleksionet *ex - situ*, në përputhje me afatet dhe kushtet e mëposhtme:

a) Burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, të dhëna në listë në shtojcën I të këtij traktati dhe të mbajtura nga IARC-të bëhen të disponueshme në përputhje me dispozitat e parashikuara në pjesën IV të këtij traktati.

b) Burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, të ndryshme nga ato që janë dhënë në listë në shtojcën I të këtij traktati dhe të mbledhura përpara hyrjes së tij në fuqi, të cilat mbahen nga IARC-të bëhen të disponueshme në përputhje me dispozitat e MTA-së që është aktualisht në përdorim, në përputhje me marrëveshjet ndërmjet IARC-ve dhe FAO-së. Kjo MTA amendohet nga organi drejtues jo më vonë se sesioni i tij i dytë i rregullt, në konsultim me IARC-të, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij traktati, në veçanti me nenet 12 dhe 13, dhe sipas kushteve të mëposhtme:

i) IARC-të informojnë në mënyrë periodike organin drejtues rreth MTA-ve të arritura, sipas një programi të përcaktuar nga organi drejtues;

ii) Palët kontraktuese, në territorin e të cilave janë mbledhur burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në kushtet *in situ*, pajisen me kampione të burimeve të tilla gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë pas bërjes së kërkesës nga ana e tyre, pa nevojën e ndonjë MTA-je;

iii) Përfitimet që dalin nga MTA-ja e sipërpërmendur e që lidhen me mekanizmat e përmendur në nenin 19.3f aplikohen, në veçanti, për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike bimore për bujqësinë dhe ushqimin në fjalë, në veçanti në programe kombëtare dhe rajonale në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion, në veçanti në qendra të diversitetit dhe të vendeve më pak të zhvilluara; dhe

iv) IARC-të marrin masat e nevojshme, në përputhje me kapacitetin e tyre, për të arritur përputhshmëri efektive me kushtet e MTA-së, dhe informojnë menjëherë organin drejtues për rastet e mospërputhjes.

c) IARC-të e njohin autoritetin e organit drejtues për ofrimin e udhëzimeve të politikave që lidhen me koleksionet *ex situ* të kryera prej tyre dhe që janë subjekt i dispozitave të këtij traktati.

d) Pajisjet shkencore dhe teknike në të cilat ruhen koleksione të tilla *ex situ* janë në kompetencën e IARC-ve, të cilat marrin përsipër të menaxhojnë dhe të administrojnë këto koleksione *ex situ* në përputhje me standardet e pranuar në nivel ndërkombëtar, në veçanti me standardet e Bankave Gjenetike, siç është parashikuar nga Komisioni i FAO-s për Burimet Gjenetike për bujqësinë dhe ushqimin.

e) Pas kërkesës nga një IARC-je, sekretari do të përpiqet të japë mbështetjen e duhur teknike.

f) Sekretari, në çdo kohë, ka të drejtë akses në ambiente, si dhe ka të drejtë të inspektojë të gjitha aktivitetet e kryera në mënyrë të drejtpërdrejtë e që lidhen me ruajtjen dhe shkëmbimin e materialit të mbuluar nga ky nen.

g) Nëse mirëmbajtja në rregull e këtyre koleksioneve *ex situ* të kryera nga ICRC-të pengohet ose kërcënohet nga ndonjë ngjarje e çdo lloji, duke përfshirë dhe forcat madhore, sekretari, me miratimin e shtetit mikpritës, ndihmon në evakuimin ose transferimin e tyre deri në masën që është e mundur.

15.2 Palët kontraktuese bien dakord të ofrojnë akses të lehtësuar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në shtojcën I, pjesa që flet për sistemin shumëpalësh për ICRC-të e OGIAR-të që kanë nënshkruar marrëveshje me organin drejtues në përputhje me këtë traktat.

Qendra të tilla përfshihen në një listë të mbajtur nga sekretari që do të bëhen të disponueshme për palët kontraktuese me kërkesë të tyre.

15.3 Materiali i ndryshëm nga materiali i përmendur në shtojcën I, i cili është marrë dhe ruhet nga IARC-të pas hyrjes së këtij traktati në fuqi është i disponueshëm për akses, sipas kushteve që janë në përputhje me kushtet e rëna dakord bashkërisht ndërmjet IARC-ve që marrin materialin e vendit të origjinës të burimeve të tilla ose vendit që i ka marrë këto burime në përputhje me konventën për diversitetin biologjik ose ligje të tjera të aplikueshme.

15.4 Palët kontraktuese inkurajohen t'i japin IARC-ve që kanë nënshkruar marrëveshje me organin drejtues akses në burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin që nuk janë listuar në shtojcën I dhe që janë të rëndësishme për programet dhe aktivitetet e IARC-ve, sipas kushteve të rëna dakord bashkërisht.

15.5 Palët kontraktuese do të kërkojnë gjithashtu të bien dakord për marrëveshje për qëllimet e dhëna në këtë nen me institucione ndërkombëtare përkatëse.

Neni 16

Rrjeti ndërkombëtar i burimeve gjenetike të bimëve

16.1 Bashkëpunimi ekzistues në rrjetin ndërkombëtar të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin do të inkurajohet ose zhvillohet mbi bazën e rregullimeve ekzistuese dhe në përputhje me kushtet e këtij traktati, në mënyrë që të arrihet mbulimi më i plotë i mundshëm i burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

16.2 Palët kontraktuese inkurajojnë, kur është e nevojshme, të gjitha institucionet përkatëse, duke përfshirë institucione private, joqeveritare, kërkimore, të përmirësimit gjenetik dhe të tjera, për të marrë pjesë në rrjete ndërkombëtare.

Neni 17

Sistemi global i informacionit për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin

17.1 Palët kontraktuese bashkëpunojnë për të zhvilluar dhe për të forcuar një sistem global informacioni për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, bazuar në sistemet ekzistuese të informacionit, për çështje shkencore, teknike dhe mjedisore të lidhura me burimet gjenetike të bimëve për ushqimet dhe bujqësinë, me shpresë që një shkëmbim i tillë informacioni do të kontribuojë për ndarjen e përfitimeve duke e bërë të disponueshëm informacionin për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin për të gjitha palët e kontraktuara. Në zhvillimin e sistemit global të informacionit, do të kërkohej bashkëpunim me mekanizmin e zhdoganimit për konventën për diversitetin biologjik.

17.2 Në bazë të njoftimit nga palët kontraktuese, jepet lajmërim paraprak rreth rreziqeve që kërcënojnë mirëmbajtjen efikase të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, në aspektin e ruajtjes së materialit.

17.3 Palët kontraktuese bashkëpunojnë me Komisionin për Burime Gjenetike për Bujqësinë dhe Ushqimin të FAO-s në rivlerësimin periodik të gjendjes së burimeve gjenetike të bimëve të botës për bujqësinë dhe ushqimin në mënyrë që të lehtësohet përditësimi i planit global të veprimit, të cilit i referohet neni 14.

PJESA VI DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 18

Burimet financiare

18.1 Palët kontraktuese marrin përsipër të zbatojnë një strategji financimi për zbatimin e këtij traktati në përputhje me dispozitat e këtij neni.

18.2 Objektivat e strategjisë së financimit janë që të rritet disponueshmëria, transparencja, efikasiteti dhe efektiviteti i ofrimit të burimeve financiare për të zbatuar aktivitetet e parashikuara në këtë traktat.

18.3 Në mënyrë që të mobilizohen fondet për aktivitetet parësore, planet dhe programet, në veçanti në vendet në zhvillim dhe në vendet me ekonomi në tranzicion, dhe duke marrë parasysh planin global të veprimit, organi drejtues përcakton periodikisht një synim për një financim të tillë.

18.4 Në bazë të kësaj strategjie financimi:

a) Palët kontraktuese marrin masat e nevojshme dhe të duhura brenda organeve drejtuese për mekanizmat përkatës ndërkombëtarë, fondet dhe organet për të siguruar përparësinë dhe vëmendjen e nevojshme për ndarjen efektive të burimeve të parashikueshme dhe të rëna dakord për zbatimin e planeve dhe programeve të parashikuara në këtë traktat.

b) Përcaktohet niveli në të cilin palët kontraktuese që janë vende në zhvillim dhe palë kontraktuese me ekonomitë në tranzicion zbatojnë në mënyrë efektive angazhimet e tyre sipas këtij traktati, varen në ndarjen efektive, në veçanti të palëve të një vendi të zhvilluar, të burimeve që u referohet ky nen. Palët kontraktuese që janë vende në zhvillim dhe Palët Kontraktuese me ekonomitë në tranzicion do t'i japin përparësinë e duhur në planet dhe programet e tyre ndërtimit të kapaciteteve në burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin.

c) Palët Kontraktuese që janë vende të zhvilluara, ofrojnë burime financiare për zbatimin e këtij traktati nëpërmjet kanaleve dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe, ndërsa palët kontraktuese që janë vende në zhvillim dhe palët kontraktuese me ekonomi në tranzicion, ndihmohen për burime të tilla. Kanale të tilla përfshijnë mekanizmat që referohen në nenin 19.3f.

d) Çdo palë kontraktuese bie dakord të ofrojë burime financiare për aktivitete kombëtare për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin në përputhje me kapacitetet kombëtare dhe burimet financiare. Burimet financiare të ofruara nuk do të përdoren për qëllime që nuk janë në përputhje me këtë traktat, në veçanti në fusha që lidhen me tregtinë ndërkombëtare të mallrave.

e) Palët kontraktuese bien dakord që përfitimet financiare që dalin nga neni 13.2 d janë pjesë e strategjisë së financimit.

f) Kontributet vullnetare mund të parashikohen edhe nga palët kontraktuese, sektori privat, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 13, organizatat joqeveritare dhe burime të tjera. Palët kontraktuese bien dakord që organi drejtues të shqyrtojë modalitete të një strategjie për të promovuar kontribute të tilla.

18.5 Palët Kontraktuese bien dakord që do t'i jepet përparësi zbatimit të planeve dhe programeve të rëna dakord për fermerët e vendeve në zhvillim, në veçanti në vendet më pak të zhvilluara, dhe ende me ekonomi në tranzicion, që ruajnë dhe përdorin në mënyrë të qëndrueshme burime gjenetike bimore për bujqësinë dhe ushqimin.

PJESA VII DISPOZITAT INSTITUCIONALE

Neni 19 **Organi drejtues**

19.1 Për këtë traktat krijohet një organ drejtues, i përbërë nga të gjitha palët kontraktuese.

19.2 Të gjitha vendimet e organit drejtues merren me konsensus ose nëse pa konsensus, me anë të një metode tjetër për të arritur në një vendim për çështje të caktuara, por konsensusi nevojitet gjithmonë në lidhje me çështjet e parashikuara në nenin 23 dhe 24.

19.3 Funkcionet e organit drejtues janë të promovojë zbatimin e plotë të këtij traktati, duke pasur parasysh objektivat e tij dhe, në veçanti:

a) Ofrimin e drejtimit të politikës dhe udhëzime për të monitoruar, dhe për të miratuar rekomandime të tilla të nevojshme për zbatimin këtij traktati, dhe në veçanti, për funksionimin e sistemit shumëpalësh;

b) Miratimin e planeve dhe programeve për zbatimin e këtij traktati;

c) Miratimin, në seancë të parë, dhe rishikimin periodik të strategjisë së financimit për zbatimin e këtij traktati, në përputhje me dispozitat e nenit 18;

d) Miratimin e buxhetit të këtij traktati;

e) Shqyrtimin dhe përcaktimin e subjektit të disponueshmërisë së fondeve të nevojshme për organe të tilla varësie, si të dalë e nevojshme, dhe mandatet dhe përbërja e tyre përkatëse;

f) Krijimin, sipas nevojës, të një mekanizmi të përshtatshëm, si për shembull të një llogarie besimi, për marrjen dhe përdorimin e burimeve financiare që përdoren për qëllime të zbatimit të këtij traktati;

g) Krijimin dhe mbajtjen e një niveli të mirë bashkëpunimi me organizata të tjera ndërkombëtare dhe organe të traktatit, duke përfshirë në veçanti Konferencën e Palëve për konventën e diversitetit biologjik, për çështje të mbuluara nga ky traktat, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në strategjinë e financimit;

h) Shqyrtimin dhe miratimin, sipas kërkesës, të amendamenteve të këtij traktati, në përputhje me dispozitat e nenit 23;

i) Shqyrtimin dhe miratimin, sipas kërkesës, të amendamenteve të shtojcave të këtij traktati, në përputhje me dispozitat e nenit 24;

j) Shqyrtimin e modaliteteve të një strategjie për të inkurajuar kontributet vullnetare, në veçanti në përputhje me nenet 13 dhe 18;

k) Kryerjen e funksioneve të tilla sipas nevojës, për plotësimin e objektivave të këtij traktati;

l) Marrjen shënim të vendimeve përkatëse të Konferencës së Palëve të Konventës për diversitet biologjik dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe organe të traktatit;

m) Informimin, siç duhet, të Konferencës së Palëve për konventën e diversitetit biologjik dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe organeve të traktatit për çështje që lidhen me zbatimin e këtij traktati; dhe

n) Miratimin e kushteve të marrëveshjes me IARC-të dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare sipas nenit 15, si dhe rishikimin dhe mendimin e MTA-ve në nenin 15.

19.4 Në varësi të nenit 19.6, çdo palë kontraktuese ka një votë dhe mund të përfaqësohet në sesionet e organit drejtues nga një delegat i vetëm që mund të shoqërohet nga një zëvendës, ose nga ekspertët dhe këshilltarët. Zëvendësit, ekspertët dhe këshilltarët mund të marrin pjesë në punimet e organit drejtues, por mund të mos votojnë, në përjashtim të rasteve kur autorizohen ligjërisht për të zëvendësuar delegatin.

19.5 Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të saj dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe çdo shtet që nuk është shtet kontraktues i këtij traktati, mund të përfaqësohet në statusin e vëzhguesit në sesionet e organit drejtues. Çdo organ apo agjenci tjetër, qoftë qeveritare ose joqeveritare, e kualifikuar në fusha të lidhura me ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin, që e ka informuar sekretarin për dëshirën për t'u përfaqësuar si vëzhgues në një sesion të organit drejtues, mund të pranohet, me përjashtim të rastit kur një e treta e palëve kontraktuese nuk kundërshtojnë. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve është subjekt i rregullores së miratuar nga organi drejtues.

19.6 Një organizatë anëtare e FAO-s që është palë kontraktuese dhe shtetet anëtare të asaj organizate anëtare që janë palë kontraktuese ushtrojnë të drejtat e tyre të anëtarësisë dhe plotësojnë detyrimet e anëtarësisë në përputhje, *mutatis mutandis*, me kushtetutën dhe me rregullat e përgjithshme të FAO-s.

19.7 Organi drejtues miraton dhe amendon, sipas kërkesës, rregulloren e tij dhe rregullat financiare, të cilat nuk duhet të jenë në kundërshtim me këtë traktat.

19.8 Prania e delegatëve që përfaqësojnë një shumicë të palëve kontraktuese është e nevojshme për të bërë një kuorum në çdo sesion të organit drejtues.

19.9 Organi drejtues mban seanca të rregullta të paktën një herë në dy vjet. Këto sesione, aq sa është e mundur, mbahen paralelisht me seancat e rregullta të Komisionit për Burime Gjenetike për bujqësinë dhe ushqimin.

19.10 Sesionet e posaçme të organit drejtues mund të mbahen në kohë të tjera, si të shihet e nevojshme nga organi drejtues, ose me kërkesë me shkrim të palëve kontraktuese, me kusht që një kërkesë e tillë mbështetet nga të paktën një e treta e palëve kontraktuese.

19.11 Organi drejtues zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarët (të cilët në mënyrë kolektive quhen “Byroja”) në përputhje me rregulloret e saj.

Neni 20 **Sekretari**

20.1 Sekretari i organit drejtues caktohet nga drejtori i përgjithshëm i FAO-s, me miratimin e organit drejtues. Sekretari ndihmohet nga një staf sipas nevojës.

20.2 Sekretari kryen funksionet e mëposhtme:

a) Bën rregullimet dhe ofron mbështetje administrative për sesionet e organit drejtues dhe për organet ndihmëse që mund të jenë krijuar;

b) Ndihmon organin drejtues në kryerjen e funksioneve të tij, duke përfshirë kryerjen e detyrave specifike që organi drejtues mund të vendosë t’ia caktojë atij.

c) Raporton për aktivitetet e tij tek organi drejtues.

20.3 Sekretari u komunikon të gjitha palëve të kontraktuara dhe drejtorit të përgjithshëm:

a) vendimet e organit drejtues brenda gjashtëdhjetë ditëve nga dita e miratimit;

b) informacionin e marrë nga palët e kontraktuara, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.

20.4 Sekretari ofron dokumentacion në gjashtë gjuhët e Kombeve të Bashkuara për organin drejtues.

20.5 Sekretari bashkëpunon me organizatat e tjera dhe me organet e traktatit, duke përfshirë në veçanti sekretariatit e konventës për diversitetin biologjik, në arritjen e objektivave të këtij traktati.

Neni 21 **Përputhshmëria**

Organi drejtues, në takimin e tij të parë, shqyrton dhe miraton procedurat e përbashkëta dhe efektive, si dhe mekanizmat operativë për të nxitur përputhshmërinë me dispozitat e këtij traktati dhe për të trajtuar çështje të mospërputhshmërisë. Këto procedura dhe mekanizma përfshijnë monitorimin, ofrimin e organimit dhe të ndihmës, duke përfshirë organim ligjor ose ndihmë ligjore, kur nevojitet, në veçanti për vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion.

Neni 22 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

21.1 Në rast të një mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij traktati, palët kërkojnë zgjidhje me atë të negociatave.

22.2 Nëse palët në fjalë nuk arrijnë një marrëveshje me anë të negociatave, ata së bashku mund të kërkojnë ndërhyrjen ose ndërmjetësimin e një pale të tretë.

22.3 Gjatë ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit në këtë traktat, ose në çdo kohë më pas, një palë kontraktuese mund t’i deklarojë me shkrim depozitarit se për një mosmarrëveshje të pazgjidhur në përputhje me nenin 22.1 ose nenin 22.2 më lart, ajo pranon njëren ose të dyja nga mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së mosmarrëveshjes si të detyrueshme:

a) Arbitrazhin në përputhje me procedurën e parashtruar në pjesën 1 të shtojcës II të këtij traktati;

b) Parashtrimin e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

22.4 Nëse palët në mosmarrëveshje, në përputhje me nenin 22.3 më lart, nuk kanë pranuar të njëjtën procedurë ose asnjë procedurë, mosmarrëveshja do të parashtrohet për pajtim në përputhje me pjesën 2 të shtojcës II të këtij traktati, në përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe.

Neni 23
Amendamentet në traktat

23.1 Amendamentet në këtë traktat mund të propozohen nga çdo palë kontraktuese.

23.2 Amendamentet në këtë traktat miratohen në një sesion të organit drejtues. Teksti i çdo mendimi të propozuar do t'u komunikohet palëve të kontraktuara nga sekretari të paktën gjashtë muaj përpara sesionit në të cilin ai është propozuar për miratim.

23.3 Të gjitha amendamentet në këtë traktat do të bëhen vetëm me konsensus të palëve kontraktuese të pranishme në sesionin e organit drejtues.

23.4 Çdo amendament i miratuar nga organi drejtues hyn në fuqi ndërmjet palëve kontraktuese që e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar atë në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit të instrumenteve për ratifikim, pranim ose miratim nga dy të tretat e palëve kontraktuese. Më pas, amendamenti hyn në fuqi për çdo palë tjetër kontraktuese në ditën e nëntëdhjetë pasi pala kontraktuese depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit të amendamentit.

23.5 Për qëllim të këtij neni, një instrument i depozituar nga një organizatë anëtare e FAO-s nuk do të numërohet si shtesë për ato amendamente të depozituara nga shtetet anëtare të një organizate të tillë.

Neni 24
Anekset

24.1 Anekset e këtij traktati formojnë një pjesë integrale të këtij traktati dhe referencat e këtij traktati do të përbëjnë në të njëjtën kohë referencë për anekset e tij.

24.2 Dispozitat e nenit 23 në lidhje me amendamentet e këtij traktati zbatohen për amendamentet e anekseve.

Neni 25
Nënshkrimi

Ky traktat është i hapur për nënshkrim në FAO nga data 3 nëntor 2001 deri më datën 4 nëntor 2002 nga të gjitha shtetet e FAO-s dhe çdo shtet që nuk është anëtar i FAO-s, por është anëtar i Kombeve të Bashkuara, ose nga çdo agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara ose Agjenci Ndërkombëtare e Energjisë Atomike.

Neni 26
Ratifikimi, pranimi dhe miratimi

Ky traktat është subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga anëtarët dhe joanëtarët e FAO-s, të cilëve u referohet neni 25. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen te depozitari.

Neni 27
Pranimi

Ky traktat është i hapur për pranim nga të gjithë anëtarët e FAO-s dhe çdo shtet që nuk është anëtar i FAO-s, por që është anëtar i Kombeve të Bashkuara, ose çdo agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara ose Agjenci Ndërkombëtare e Energjisë Atomike që nga data në të cilën traktati është i mbyllur për nënshkrim. Instrumentet e pranimit do të depozitohen te depozitari.

Neni 28
Hyrja në fuqi

28.1 Sipas dispozitave të nenit 29.2, ky traktat do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të dyzet të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me kusht që të paktën të jenë depozituar njëzet instrumente të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit nga anëtarët e FAO-s.

28.2 Për çdo anëtar të FAO-s dhe çdo shtet që nuk është anëtar i FAO-s, por është anëtar i Kombeve të Bashkuara, ose për çdo nga agjencitë e tij të specializuara ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike që ratifikon, pranon, miraton dhe aderon në këtë traktat pas depozitimit, në përputhje me nenin 28.1, të instrumentit të dyzet të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit, traktati hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 29
Organizatat anëtare të FAO-s

29.1 Kur një organizatë anëtare e FAO-s depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi për këtë traktat, organizata anëtare, në përputhje me dispozitat e nenin II.7 të Kushtetutës së FAO-s, njofton ndryshimet në lidhje me shpërndarjen e kompetencës për deklarimin e kompetencave që jepen sipas nenit II.5 të Kushtetutës së FAO-s siç mund të jetë e nevojshme nga pikëpamja e pranimit të këtij traktati. Çdo palë kontraktuese për këtë traktat, në çdo kohë, mund t'i kërkojë një organizatë anëtare të FAO-s që është palë kontraktuese në këtë traktat të japë informacion se cila nga organizatat anëtare apo shtetet anëtare është përgjegjëse për zbatimin e ndonjë çështje të veçantë të mbuluar nga ky traktat. Organizata anëtare jep informacion brenda një kohe të arsyeshme.

29.2 Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimi, aderimit ose tërheqjes, të depozituara nga një shtet anëtar i FAO-s, nuk do të numërohen si shtesa të akteve të depozituara nga shtetet anëtare.

Neni 30
Rezervat

Nuk bëhen rezerva për këtë traktat.

Neni 31
Jopalët

Palët kontraktuese inkurajojnë çdo shtet të FAO-s ose çdo shtet tjetër që nuk është palë kontraktuese e këtij traktati, ta pranojnë këtë traktat.

Neni 32
Tërheqjet

32.1 Çdo palë kontraktuese, në çdo kohë, pas një periudhe dyvjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij traktati, mund të njoftojë me shkrim depozitarin për tërheqjen e saj nga ky traktat. Depozitari informon menjëherë palët kontraktuese.

32.2 Tërheqja do të bëhet efektive një vit pas datës së marrjes së njoftimit.

Neni 33
Përfundimi

33.1 Traktati përfundon në mënyrë automatike nëse dhe kur, si rezultat i tërheqjeve, numri i palëve kontraktuese ka zbritur deri në dyzet, me përjashtim të rasteve kur palëve kontraktuese që mbeten kanë vendosur ndryshe.

33.2 Depozitari informon të gjitha palët kontraktuese që mbeten kur numri i palëve kontraktuese zbret në dyzet.

33.4 Në rast të përfundimit të traktatit, rregullimi i aseteve do të bëhet në bazë të rregullave financiare që do të miratohen nga organi drejtues.

Neni 34
Depozitari

Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s do të jetë depozitari i këtij traktati.

Neni 35
Tekstet origjinale

Tekstet e këtij traktati në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëjloj të barasvlershme.

LIGJ
Nr.10 236, datë 18.2.2010

PËR MARRJEN NË KONTROLL TË SHOQËRIVE ME OFERTË PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike.

2. Ky ligj zbatohet për ofertat e shpallura publikisht për marrjen në zotërim të titujve, të emetuar nga një shoqëri publike, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në tregun e organizuar të titujve të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, si dhe nga shoqëritë publike të huaja, me seli brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të listuara në bursë në Shqipëri.

3. Ky ligj nuk zbatohet për ofertat për marrjen në zotërim të titujve të emetuar nga shoqëritë, objekti i të cilave është investimi kolektiv i kapitalit të siguruar nga publiku, që ushtrojnë veprimtari në bazë të parimit të shpërndarjes së rrezikut dhe kuotat e të cilave riblihen ose shlyhen, me kërkesë të mbajtësve të tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga pasuritë e këtyre shoqërive. Masat e marra nga shoqëri të tilla, për t'u kujdesur që vlera në bursë e njësive të tyre të mos ndryshojë ndjeshëm nga vlera e aseteve neto të tyre, vlerësohen si ekuivalente të riblerjes ose të shlyerjes.

4. Ky ligj nuk zbatohet për titujt e emetuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Administratë e shoqërisë tregtare” janë organet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, në përputhje me parashikimet e shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të nenit 134 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

b) “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

c) “Bashkëpunimi” është veçanërisht, por jo vetëm, veprimi i grupit të shoqërive, i cili përbëhet nga shoqëria mëmë, shoqëritë e kontrolluara dhe entitete të tjera, mbi të cilat shoqëria mëmë ose shoqëria e kontrolluar ushtron një influencë dominuese ose një interes pjesëmarrjeje.

ç) “Influencë dominuese” është ndikimi kontrollues i një shoqërie mëmë ose një marrëdhënie ndërmjet një personi dhe shoqërisë:

i) me anë të së cilës personi me influencë ka mundësi për të vendosur për shpërndarjen e të ardhurave të shoqërisë, diversifikimin e fitimit apo të humbjes së një shoqërie tjetër, ose ka ndikim mbi strategjinë e shoqërisë a politikat e saj të biznesit apo të shitjes;

ii) e cila lejon bashkërendimin e menaxhimit të shoqërisë me një shoqëri tjetër për një objektiv të përbashkët, pavarësisht nëse marrëveshja është e fiksuar në dokumentet e themelimit të shoqërisë apo në ndonjë kontratë tjetër;

iii) me anë të së cilës ka ndikim në menaxhimin e përbashkët, nëpërmjet bordit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës apo këshillit të administrimit, i cili përbëhet nga të gjithë ose disa nga personat e njëjtë (të cilët përbëjnë shumicën e nevojshme të vendimmarrjes);

iv) me anë të së cilës personi me influencë është në gjendje të ushtrojë një ndikim të konsiderueshëm në funksionimin e një shoqërie tjetër, pa qenë i përfshirë në kapitalin e saj;

d) “Interes pjesëmarrjeje” është marrëdhënia ndërmjet një personi fizik dhe juridik, përjashtuar influencën dominuese, e cila përbën zotërimin e drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të 20 për qind ose më shumë të të drejtave të votës apo të kapitalit në një shoqëri.

dh) “Kontroll” është marrja në zotërim e të paktën 30 për qind të të drejtave të votës së shoqërisë, objekt i ofertës. Për të vendosur përqindjen e zotërimit, llogariten, në total, kontrolli i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, zotërimi i personave, që veprojnë në bashkëpunim dhe zotërimi i personave të afërm.

e) “Marrja në zotërim” është zotërimi me anë të blerjes apo me ndonjë mënyrë tjetër e aksioneve apo e të drejtave të votës në shoqërinë, objekt i ofertës, përfshirë edhe opsione blerjeje dhe riblerjeje për aksione, të cilat kanë të drejtë vote, opsione blerjeje për kontratat futures ose ushtrimi i së drejtës së votës nëpërmjet pronësisë si përfitues. Zotërimi, përveçse nëpërmjet ofertës së drejtpërdrejtë, të dhënë nga blerësi, merret nga çdo lloj veprimi tjetër, si nëpërmjet trashëgimit apo prishjes së një shoqërie, e cila ndikon në të drejtat e votave të aksioneve apo ndryshon përqindjen e votimit, ose nëpërmjet bashkëpunimit të personave, që veprojnë në bashkëpunim, të cilët kanë si qëllim marrjen në zotërim.

ë) “Ofertë” është oferta e shpallur publikisht, që ka për qëllim zotërimin e titujve të një shoqërie publike kundrejt mjeteve monetare apo në këmbim të titujve të tjerë.

f) “Ofertë e detyrueshme” është oferta që duhet të bëhet detyrimisht, nëse arrihet marrja e kontrollit të një shoqërie publike, sipas nenit 28 të këtij ligji.

g) “Ofertë e shpallur publikisht” është oferta, që bëhet publike me anë të mjeteve masive të komunikimit.

gj) “Ofertë për marrje në kontroll” është oferta e shpallur publikisht për të marrë në zotërim tituj e një shoqërie, objekt i ofertës, nga një ofrues, i cili, së bashku me personat që veprojnë në bashkëpunim, synon të kalojë kufirin e kontrollit për shoqërinë, objekt i ofertës.

h) “Ofertë vullnetare e pjesshme” është oferta, që ka për qëllim marrjen në zotërim të titujve, të cilët nuk i japin ofruesit dhe personave që veprojnë në bashkëpunim me të kontrollin mbi shoqërinë, objekt i ofertës.

i) "Ofruesi" është personi fizik apo juridik, i cili bën një ofertë për të marrë në zotërim titujt e shoqërisë, objekt i ofertës.

j) "Palët e ofertës" janë ofruesi, anëtarët e administratës së ofruesit, kur ky është shoqëri tregtare, shoqëria objekt i ofertës, zotëruesit e titujve të shoqërisë, objekt i ofertës, anëtarët e administratës së shoqërisë, objekt i ofertës, si dhe personat, që veprojnë në bashkëpunim me këto palë.

k) "Person me influencë" është çdo person, që ushtron ndikim mbi të licencuarin, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një pale të tretë. Këtu përfshihet, pa kufizim, çdo person që përcakton veprimet e drejtuesve të shoqërisë së rregulluar nga ky ligj, mendimet e të cilëve ndikojnë në procesin e vendimmarrjes së të licencuarit.

l) "Persona që veprojnë në bashkëpunim" janë persona fizikë ose juridikë, të cilët bashkëpunojnë me ofruesin apo shoqërinë, objekt i ofertës, në bazë të një marrëveshjeje të heshtur ose të shprehur në mënyrë verbale apo të shkruar, për marrjen e kontrollit të shoqërisë, objekt i ofertës, ose prishjen e rezultatit të suksesshëm të një oferte. Shoqëritë e kontrolluara të ofruesit ose të shoqërisë, objekt i ofertës, sipas kuptimit të nenit 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", vlerësohen si persona, që veprojnë në bashkëpunim.

ll) "Shoqëri publike" është shoqëria aksionare me ofertë publike, e cila regjistron aksionet e saj në kuotim burse, në përputhje me nenin 105 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "Për titujt".

m) "Shoqëria objekt i ofertës" është shoqëria publike, titujt e së cilës janë objekt i një oferte për marrje në zotërim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

n) "Titujt" janë titujt e transferueshëm me të drejtë vote në shoqëri, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "Për titujt".

nj) "Treg i organizuar" është bursa apo një treg tjetër i rregulluar titujsh, i autorizuar, rregulluar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.8.2008 "Për titujt".

o) "Zotërimi dhe kontrolli jo i drejtpërdrejtë", është kur aksionet apo të drejtat e votës të një shoqërie janë të kontrolluara nëpërmjet aksioneve apo të drejtat e votës janë të zotëruara nga një shoqëri tjetër në këtë shoqëri (shoqëri e varur). Përmasat e zotërimit dhe kontrollit jo të drejtpërdrejtë përcaktohen duke shumëfishuar aksionet apo të drejtat e votës, të zotëruara nga shoqëria e varur me aksionet e të drejtat e votës, kush është më e madhja, të mbajtura nga shoqëria e varur e shoqërisë, objekt i ofertës. Nëse aksioni apo e drejta e votës është më e lartë se 50 për qind, do të trajtohet si një e plotë.

Neni 3

Parime të përgjithshme

Dispozitat e këtij ligji mbështeten në parimet e mëposhtme:

a) zotëruesit e titujve të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, të cilët i përkasin së njëjtës kategori, trajtohen në mënyrë të njëjtë;

b) nëse personi fizik apo juridik merr kontrollin e shoqërisë, objekt i ofertës mbrojtja e zotëruesve të tjerë të titujve është e garantuar;

c) zotëruesve të titujve të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, u sigurohet koha dhe informacioni i nevojshëm për marrjen e vendimit për ofertën në rastet kur këshillon zotëruesit e titujve, bordi i shoqërisë, objekt i ofertës, jep pikëpamjet e tij në lidhje me efektet e zbatimit të ofertës mbi punësimin, kushtet e punësimit dhe vendndodhjes së zyrave ku kompania ushtron biznesin;

ç) zotëruesi nuk duhet të ftojë aksionarët e shoqërisë, objekt i ofertës, që t'i bëjnë një ofertë për të shitur aksionet e veta;

d) administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, duhet të veprojë në interesin më të mirë të shoqërisë, si një e tërë, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 163 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

dh) krijimi i tregjeve të rreme për titujt e shoqërisë, objekt i ofertës, të shoqërisë që bën ofertën ose të një shoqërie tjetër, të prekur nga oferta, të cilat synojnë rritje apo rënie artificiale të çmimeve të titujve dhe që dëmtojnë funksionimin normal të tregjeve, është i ndaluar;

e) ofruesi bën njoftimin për ofertën vetëm kur garanton se mund të paguajë tërësisht mjetet monetare, nëse ofron të tilla, si dhe vetëm kur ka marrë të gjitha masat e arsyeshme, që garantojnë zbatimin e çdo lloji tjetër pagese;

ë) shoqëria tregtare, objekt i ofertës, nuk duhet të pengohet në ushtrimin e veprimtarisë së vet nga një ofertë për të blerë titujt e saj për një periudhë më të gjatë nga sa është e nevojshme.

Neni 4

Të dhëna për shoqëritë aksionare, subjekte të këtij ligji

1. Shoqëritë aksionare, subjekte të këtij ligji, publikojnë në raport dhe pasqyrat financiare vjetore të dhëna të hollësishme për:

a) strukturën e kapitalit, përfshirë edhe titujt, të cilët nuk pranohen për tregtim në tregun e rregulluar, duke përcaktuar kategoritë e ndryshme të aksioneve dhe për secilën kategori, të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin prej tyre dhe përqindjen e kapitalit aksionar, gjithsej, që përfaqësojnë;

b) kufizimet, nëse ka, për kalimin e titujve, siç janë kufizimet për zotërimin e titujve apo detyrimi për të marrë miratimin e shoqërisë a të zotëruesve të tjerë të titujve;

c) zotërimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta, sipas nenit 206 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

ç) zotëruesit e titujve me të drejta të posaçme kontrolli dhe një përshkrim të këtyre të drejtave;

d) sistemin e kontrollit të skemës së aksioneve të punëmarrësve, nëse ka, kur të drejtat e kontrollit nuk ushtrohen drejtpërdrejt nga punëmarrësit;

dh) normat, që rregullojnë emërimin dhe largimin e administratës së shoqërisë dhe ndryshimin e statutit;

e) kompetencat e anëtarëve të bordit të shoqërisë, në veçanti kompetencat për të emetuar dhe riblerë aksione;

ë) aktmarrëveshjet, ku shoqëria është palë, të cilat hyjnë në fuqi, ndryshojnë ose zgjidhen me ndryshimin e kontrollit të shoqërisë pas një oferte për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve, kur, për shkak të natyrës së tyre, të dhënat për to do të cenojnë rëndë shoqërinë tregtare. Ky përjashtim nuk zbatohet kur shoqëria tregtare ka detyrimin specifik për t'i bërë të ditura të dhëna të tilla në bazë të kërkesave të tjera ligjore, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

f) aktmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë tregtare dhe anëtarëve të këshillit apo punëmarrësve të saj, ku parashikohet kompensim, nëse ata, përkatësisht, japin dorëheqjen ose kur shkurtohet vendi i tyre i punës pa shkak të arsyeshëm, apo kur zgjidhen marrëdhëniet e punës me ta, për shkak të një oferte për marrje në kontroll.

g) çdo kufizim në të drejtat e votimit, si kufizimet e të drejtave të votimit të zotëruesve të një përqindjeje ose numri të caktuar të votave, afatet për ushtrimin e të drejtave të votimit ose sistemet, përmes të cilave, në bashkëpunim me kompaninë, të drejtat financiare që lidhen me titujt janë të ndara nga zotëruesit e titujve;

gj) çdo marrëveshje ndërmjet zotëruesve të aksioneve, të njohura nga kompania dhe që mund të rezultojnë në kufizime të transferimit të aksioneve dhe/ose të drejtave të votimit.

2. Administrata e shoqërisë, në mbledhjen vjetore të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, paraqet një relacion shpjegues për çështjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti miraton rregullore për të përcaktuar të dhënat shtesë, që mund të përfshihen në raportin dhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërive aksionare.

KREU II OFERTAT PËR MARRJE NË KONTROLL

Neni 5 Pjesëmarrësit e ofertës

1. Oferta për marrje në kontroll i drejtohet të gjithë aksionarëve të shoqërisë, objekt i ofertës, për të gjitha aksionet e shoqërisë.

2. Për të krijuar një përqindje kontrolluese, të drejtat e votës të personave, që veprojnë në bashkëpunim me ofruesin, vlerësohen si të drejta vote të vetë ofruesit.

Neni 6 Njoftimi i vendimit për të bërë ofertën

1. Përpara se të bëjë ofertën e marrjes në kontroll, ofruesi njofton me shkrim Autoritetin dhe administratorët e shoqërisë, objekt i ofertës.

2. Vendimi për bërjen e ofertës shpallet në faqen e internetit të ofruesit, në rastin kur lidhet me një person juridik, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në rastin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në regjistrin përkatës të titujve dhe në mjetet zyrtare të informimit të tregut të organizuar të titujve, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

3. Ofruesi dhe shoqëria, objekt i ofertës, njoftojnë për vendimin për bërjen e ofertës punëmarrësit dhe, në rastin e shoqërive, këshillat e punëmarrësve të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 7 Përgatitja dhe publikimi i dokumentit të ofertës

1. Ofruesi, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit për bërjen e ofertës, i paraqet Autoritetit për miratim dokumentin e ofertës.

2. Dokumenti i ofertës përmban, të paktën, të dhënat:

a) e identifikimit të ofruesit dhe, kur ofruesi është shoqëri tregtare, formën, emrin dhe selinë e regjistruar të kësaj shoqërie;

b) për emrin, selinë e regjistruar dhe formën e shoqërisë, objekt i ofertës;

c) e identifikimit të personave, që veprojnë në bashkëpunim me ofruesin ose me shoqërinë tregtare, objekt i ofertës dhe, në rastin e shoqërive tregtare, formën e tyre, emrin, selinë e regjistruar dhe marrëdhënien me ofruesin apo shoqërinë tregtare objekt i ofertës;

ç) për zotërimet ekzistuese të titujve nga ofruesi apo për persona, që veprojnë në bashkëpunim me të, në shoqërinë tregtare, objekt i ofertës, nëse ka;

d) për titujt dhe, nëse ka, kategoritë e titujve, për të cilat bëhet oferta;

dh) për përqindjet apo sasi të maksimale dhe minimale të titujve, që ofruesi propozon të blejë;

e) për llojin dhe masën e pagesës së ofruar për çdo titull dhe, kur pagesa e ofruar përfshin aksione, të dhëna për vlerën mesatare të ponderuar të tregut të këtyre aksioneve gjatë 12 muajve të fundit, si dhe për të drejtat e votës që mbartin;

ë) për vlerën e huasë së kërkuar nga ofruesi për të financuar ofertën për marrjen në kontroll, masat e marra nga ai për të garantuar financimin e ofertës, si dhe pasojat që pritet të ketë pranimi i ofertës në gjendjen financiare të ofruesit;

f) për kushtet dhe afatet, të cilave u nënshtrohet oferta për marrje në kontroll;

g) për synimet e ofruesit për veprimtarinë tregtare të ardhshme të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës dhe, për atë që preket nga oferta, të shoqërisë ofruese, masat mbrojtëse që synohen të merren për ruajtjen e vendeve të punës të punonjësve dhe të administratorëve, si dhe ndryshimet materiale në kushtet e marrëdhënieve të punës. Këtu përfshihen, në veçanti, planet strategjike të

ofruesit për të dy shoqëritë tregtare, si edhe pasojat e mundshme për marrëdhëniet e punës dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërive;

gj) për kohën e lejuar për pranimin e ofertës për marrje në kontroll;

h) për masat, që duhet të merren nga zotëruesit e titujve, për të pranuar ofertën dhe për të marrë pagesën përkatëse për to;

i) për qëllimin e ofruesit lidhur me të drejtën për të larguar aksionarët e vegjël, të parashikuar në nenin 25 të këtij ligji, nëse arrihet pragu i përcaktuar;

j) për ligjin, që do të zbatohet për kontratat, që do të lidhen si rezultat i ofertës ndërmjet ofruesit dhe zotëruesve të titujve të shoqërisë tregtare objekt i ofertës, si dhe gjykatën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

3. Dokumenti i ofertës publikohet menjëherë pas miratimit nga Autoriteti. Nëse Autoriteti, brenda 10 ditëve pune pas marrjes së dokumentit të ofertës, nuk shprehet për dokumentin e ofertës, atëherë miratimi i këtij dokumenti do të merret si i mirëqenë dhe ofruesi ka të drejtë ta publikojë atë menjëherë pas përfundimit të afatit 10-ditor. Për publikimin e dokumentit të ofertës zbatohen parashikimet e pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji.

4. Ofruesi dhe shoqëria, objekt i ofertës, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, njoftojnë për dokumentin e ofertës punëmarrësit apo, në rastin e shoqërive tregtare, këshillat e punëmarrësve të tyre.

5. Kur nga përfitimi i kontrollit, që parashikohet të ndodhë, si rezultat i publikimit të dokumentit të ofertës, mund të krijohet një përqendrim, në kuptim të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për këtë përqendrim për të marrë autorizimin, sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji.

Neni 8

Këshillimi i paanshëm, komitetet e pavarura dhe miratimi nga aksionarët

1. Bordi drejtues i një shoqërie, objekt i ofertës, kur ekziston mundësia e marrjes së një oferte, angazhon një këshilltar financiar të paanshëm për t'u këshilluar, nëse oferta është e pandershme dhe e paarsyeshme. Kjo këshillë, përfshirë edhe arsyetimet, duhet marrë me shkrim dhe, së bashku me rekomandimin e bordit drejtues të shoqërisë, objekt i ofertës, për pranimin e ofertës, u bëhet e njohur aksionarëve, nëpërmjet përfshirjes së saj në dokumentin e përgjigjes së ofertës. Nëse ndonjëri nga drejtuesit e shoqërisë, objekt i ofertës, është në konflikt interesash, bordi i kësaj shoqërie krijon një komitet të pavarur, për të shmangur përgjegjësinë e vet për ofertën.

2. Nëse ndonjëri nga drejtuesit e bordit të shoqërisë ofruese është në konflikt interesash, si rezultat i ofertës së bërë, bordi i kësaj shoqërie krijon një komitet të pavarur, për të bërë vlerësimin e ofertës së propozuar. Nëse konflikti është i natyrës materiale, Autoriteti vendos, ndër të tjera, nëse do të jetë i nevojshëm angazhimi i një këshilltari të paanshëm financiar nga bordi i shoqërisë ofruese për të këshilluar, sipas rastit, aksionarët e vet, si edhe nëse oferta duhet të jetë e kushtëzuar nga miratimi i shumicës së votave të dhëna nga këta aksionarë, qoftë duke qenë vetë të pranishëm ose të përfaqësuar nga persona të tjerë, në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve të kësaj shoqërie.

3. Një person, i cili ka ose ka pasur një lidhje financiare apo të një lloji tjetër me shoqërinë ofruese a shoqërinë, objekt i ofertës, e cila është e një natyre, që shkakton konflikt interesash, vlerësohet person i papërshtatshëm për dhënien e këshillës së paanshme.

4. Një këshilltar financiar nuk mund të vlerësohet i pavarur, nëse ka marrëdhënie me shoqërinë ofruese apo atë, objekt i ofertës, ose me aksionarët kryesorë të secilës prej tyre, të cilët cenojnë objektivitetin e këshillës që jep. Në qoftë se ka aksionarë në secilën shoqëri që nuk janë të paanshëm, sepse kanë interesa të tjerë në transaksionin e propozuar, të ndryshëm nga interesi i të qenit aksionar, këshilltari i paanshëm duhet të përpiqet për të mbrojtur interesat e shoqërisë ofruese dhe të shoqërisë, objekt i ofertës, duke u kujdesur vetëm për interesat e aksionarëve të paanshëm, të cilët nuk kanë asnjë interes tjetër në transaksionin e propozuar, përveç interesit si aksionar.

5. Komiteti i pavarur i bordit të një shoqërie përbëhet nga drejtues, të cilët nuk kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ofertën që shqyrtojnë, përveç interesit si aksionar i shoqërisë,

objekt i ofertës. Për këtë arsye, punonjësit e një shoqërie, objekt i ofertës, që janë të lidhur me shoqërinë ofruese, vlerësohen se kanë interes të tërthortë e për këtë arsye nuk janë të pavarur. I njëjti përcaktim vlen për punonjësit, drejtuesit, agjentët, partnerët, të afërmit dhe të lidhurit me ndonjë person, që ushtron kontroll apo drejtim për veprimtarinë e shoqërisë, objekt i ofertës, nëse një person i tillë ka interes të drejtpërdrejtë në ofertë. Për këtë qëllim, quhet “person i lidhur”, personi që kontrollon, kontrollohet ose është në të njëjtin kontroll, së bashku me personin në fjalë. Në raste paqartësie bëhet këshillimi i nevojshëm me Autoritetin. Nëse komiteti i bordit të drejtuesve në fakt nuk është i pavarur, ai nuk karakterizohet si i tillë. Në qoftë se është i pamundur krijimi i një komiteti të pavarur, përgjegjësia për ruajtjen e interesave të aksionarëve të pavarur i takon kryesisht këshilltarit të pavarur.

Neni 9

Ofertat e ndaluara

Autoriteti ndalon ofertën për marrjen në kontroll nëse:

a) ofruesi nuk ka paraqitur dokumentin e ofertës brenda 10 ditëve nga data e publikimit të vendimit për bërjen e një oferte;

b) dokumenti i ofertës nuk përmban elementet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 7 të këtij ligji;

c) informacioni, që përmban dokumenti i ofertës, bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

ç) ofruesi nuk e ka publikuar dokumentin e ofertës, në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji.

2. Autoriteti këshillon dhe diskuton me ofruesin çështjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, për të korrigjuar veprimet apo mosveprimet e tij, që nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Në rast se oferta për marrjen në kontroll nuk lejohet në bazë të pikës 1 të këtij neni dhe kur oferta ndalohet nga Autoriteti i Konkurrencës, dokumenti i ofertës nuk publikohet.

4. Kontrata për blerjen e titujve të shoqërisë, objekt i ofertës, që mbështetet në një ofertë të ndaluar, është e pavlefshme. Nëse kontrolli apo zotërimi merret në mënyrë të paligjshme, atëherë marrësi nuk mund të ushtrojë të drejtat, që rrjedhin nga aksionet (përfshirë të drejtat e votës edhe të drejtën për të marrë dividend), derisa ai të përfundojë kontrollin apo zotërimin e tij, të cilin e ka marrë duke shkelur dispozitat e këtij ligji, duke shitur sasinë e duhur të aksioneve.

Neni 10

Përgjegjësia për vërtetësinë e dokumentit të ofertës

Ofruesi mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuara aksionarëve, të cilët e kanë pranuar ofertën, nëse, brenda 2 vjetëve pas përfundimit të ofertës për marrjen në kontroll, këta aksionarë paraqesin prova se dokumenti i ofertës ishte i pasaktë dhe i paplotë, me përjashtim të rasteve kur ofruesi provon se:

a) nuk ka qenë në dijeni të këtyre mangësive, pavarësisht përpjekjeve kërkimore të arsyeshme;

b) aksionarët, të cilët kanë pranuar ofertën, kanë qenë në dijeni ose rrethanat kanë qenë aq të dukshme sa ato duhet të ishin në dijeni të këtyre mangësive.

Neni 11

Kushtet dhe revokimi

1. Oferta për marrjen në kontroll përmban kushte, në rastet kur realizimi i tyre nuk varet vetëm nga ofruesi ose personat që veprojnë në bashkëpunim me të.

2. Ofruesi revokon ofertën për marrje në kontroll, përveçse kur ka përfunduar periudha kohore e lejuar për të pranuar ofertën, por edhe atëherë vetëm nëse njëra nga kushtet e lejuara të ofertës për marrjen në kontroll nuk është përmbushur apo nuk është hequr dorë.

Neni 12

Koha e lejuar për pranimin e ofertës

1. Koha e lejuar për pranimin e ofertës për marrje në kontroll nuk duhet të jetë më pak se 3 javë dhe më shumë se 10 javë nga data e publikimit të dokumentit të ofertës.

2. Nëse shoqëria, objekt i ofertës, thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për të vendosur për ofertën për marrjen në kontroll, koha e lejuar për pranimin është 10 javë nga data e publikimit të dokumentit të ofertës. Administratori i shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë ofruesin dhe Autoritetin për thirrjen e asamblesë së përgjithshme. Ofruesi publikon menjëherë këtë informacion, në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme, sipas pikës 2 të këtij neni, thirret jo më vonë se 21 ditë kalendrike para datës së parashikuar për mbajtjen e mbledhjes së kësaj asambleje, por me kusht që mbledhja të mos zhvillohet 21 ditë para datës së publikimit të dokumentit të ofertës. Ky afat është i vlefshëm edhe për informacionin që vihet në dispozicion të aksionarëve, në bazë të pikës 3 të nenit 137 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 13

Çmimi i drejtë

1. Ofruesi duhet të ofrojë një çmim të drejtë për aksionet e të njëjtit lloj apo kategori të shoqërisë, objekt i ofertës. Çmimi, përkatësisht, vlera shkëmbyese e ofertës për të marrë në kontroll nuk duhet të jetë më e ulët se vlera më e lartë e:

a) çmimit të drejtë të aksioneve të llogaritura në bazë të mënyrave të vlerësimit, të pranuar dhe të njohura nga të gjithë;

b) çmimit mesatar të ponderuar të tregut të aksioneve për 3 muajt e fundit;

c) çmimit më të lartë për çdo aksion, i paguar nga ofruesi ose nga persona, që veprojnë në bashkëpunim me të gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, përpara datës së bërjes së ofertës për marrje në kontroll. Në rast se çmimi i aksionit nuk mund të përcaktohet sipas kësaj mënyre, ai përcaktohet si çmimi më i lartë ndërmjet vlerës së fundit të emetimit dhe vlerës së fundit të paguar nga ofruesi.

2. Autoriteti nxjerr rregulla të detajuara për mënyrën e përcaktimit të çmimit të drejtë.

3. Pagesa e ofruar nga ofruesi është në mjete monetare ose në aksione të tregtueshme në tregun e organizuar, nëse aksionet janë mjaftueshmërisht likuide dhe aktive. Zotëruesve të aksioneve me të drejtë vote u ofrohen si kundërvlerë aksione me të drejtë vote.

4. Ofruesi ofron mjete monetare, kur ai ose personat që veprojnë në bashkëpunim me të, kanë blerë me mjete monetare të paktën 5 për qind të aksioneve ose të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, gjatë gjashtë muajve të fundit përpara datës së publikimit të vendimit për të bërë ofertën.

5. Nëse ofruesi apo personat që veprojnë në bashkëpunim me të, brenda 1 viti nga data e publikimit të dokumentit të ofertës, kanë marrë aksione të shoqërisë, objekt i ofertës, me një çmim më të lartë se ai i parashikuar në ofertë, ofruesi u paguan aksionarëve, të cilët kanë pranuar ofertën, diferencën e çmimit. Ky rregull nuk zbatohet:

a) nëse aksionet janë marrë në përmbushje të një detyrimi ligjor për të dëmshpërblyer aksionarët e shoqërisë, objekt i ofertës;

b) në rastin e blerjes së aktiveve të shoqërisë, objekt i ofertës, gjatë një bashkimi ose ndarje shoqërishe, sipas parashikimeve të nenit 214 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

c) në rastin e ushtrimit të një të drejte parablerjeje gjatë zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, objekt i ofertës, në përputhje me nenin 174 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 14

Vlerësimi nga administrata dhe këshilli i punëmarrësve të shoqërisë, objekt i ofertës

1. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, brenda 10 ditëve nga data e publikimit të dokumentit të ofertës apo të ndryshimeve të bëra në të, harton dhe publikon një dokument, ku paraqet opinionin e vet për ofertën për marrje në kontroll, duke analizuar pasojat që mund të ketë zbatimi i ofertës mbi interesat e shoqërisë, përfshirë dhe pasojat në marrëdhëniet e punës. Ky dokument përmban edhe pasojat që mund të kenë për shoqërinë tregtare, objekt i ofertës, planet strategjike të parashikuara nga ofruesi në dokumentin e ofertës, duke përfshirë këtu edhe pasojat e mundshme të këtyre planeve për marrëdhëniet e punës dhe vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë. Në këtë dokument jepen edhe arsyet, për të cilat administrata e shoqërisë tregtare mbështet opinionin e mësipërm.

2. Administrata ia komunikon, në të njëjtën kohë, këtë opinion edhe këshillit të punëmarrësve, i cili harton një opinion të veçantë për pasojat e ofertës për marrjen në kontroll në marrëdhëniet e punës, që i bashkëlidhet opinionit të hartuar nga administrata.

3. Dokumenti publikohet në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 15

Veprimet që kryen administrata e shoqërisë, objekt i ofertës

Nga çasti i publikimit të vendimit për të bërë ofertën, deri në çastin e publikimit të rezultateve, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji, administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, nuk duhet të kryejë veprime, të cilat mund të pengojnë realizimin e ofertës për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve kur:

a) këto veprime, sipas neneve 163 e 167 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, do të kryheshin nga administrata e një shoqërie në përmbushje të detyrave të veta, edhe nëse shoqëria nuk do të kishte marrë një ofertë për marrje në kontroll;

b) administrata kërkon një ofertë alternative.

Neni 16

Kufizim me zgjedhje i masave mbrojtëse

1. Asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilësuar votash, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendos moszbatimin e nenit 15 të këtij ligji.

2. Në këtë rast, pas publikimit të vendimit për të bërë ofertën, deri në çastin e publikimit të rezultateve, administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, nuk mund të kryejë veprime, të cilat çojnë në pengim të ofertës për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve kur:

a) veprimet janë autorizuar nga asambleja e përgjithshme, pas publikimit të vendimit për të bërë ofertën;

b) veprimet janë pjesë e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë;

c) veprimet nuk bëjnë pjesë në ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë, por kryhen në zbatim të vendimeve të marra përpara datës së publikimit të vendimit, për të bërë ofertën dhe kanë filluar të zbatohen para kësaj date;

ç) administrata kërkon një ofertë alternative.

3. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë Autoritetin për vendimin e marrë nga asambleja e përgjithshme, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi i asamblesë publikohet menjëherë edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës.

Neni 17

Moszbatimi i kufizimeve në lidhje me kalimin e aksioneve

1. Asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilësuar votash, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendos zbatimin e normave të mëposhtme:

a) gjatë kohës së lejuar për pranimin e ofertës për marrjen në kontroll, të mos zbatohen ndaj ofruesit kufizimet e vendosura për kalimin e aksioneve, të parashikuara në statutin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në aktmarrëveshjet e bëra ndërmjet shoqërisë, objekt i ofertës dhe zotëruesve të aksioneve të saj ose në kontratat ndërmjet zotëruesve të aksioneve të një shoqërie, objekt i ofertës.

b) kur, pas një oferte për marrjen në kontroll, ofruesi ka 75 për qind ose më shumë të kapitalit me të drejtë vote, kufizimet për kalimin e aksioneve, të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike dhe të drejtat e jashtëzakonshme të aksionarëve për emërimin apo shkarkimin e anëtarëve të këshillit, të parashikuara në statutin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës, nuk zbatohen në mbledhjen e parë të asamblesë së përgjithshme të thirrur nga ofruesi, me qëllim për të bërë shtesa dhe ndryshime në statut apo për të shkarkuar ose emëruar anëtarë të administratës. Për këtë qëllim, ofruesi ka të drejtën ta thërrasë, brenda një periudhe shumë të shkurtër, asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

2. Parashikimet e shkronjave “a” e “b” të pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për aksionet me përparësi pa të drejtë vote.

3. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë Autoritetin për vendimin e marrë nga asambleja e përgjithshme, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni. Vendimi publikohet menjëherë edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës.

4. Kur në bazë të pikës 1 të këtij neni u janë shkelur të drejtat, zotëruesit e këtyre të drejtave mund t'i kërkojnë ofruesit dëmshpërblim për çdo humbje të shkaktuar. Shuma minimale e dëmshpërblimit duhet të përcaktohet në dokumentet e themelimit të shoqërisë, objekt i ofertës, dhe nuk duhet të tejkalojë vlerën e kapitalit të kësaj shoqërie shumëzuar me numrin e të drejtave të votës, që kanë aksionet me përparësi. Dëmshpërblimi duhet të paguhet nga ofruesi në mjete monetare jo më vonë se 8 ditë pune pas datës së përfundimit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

5. E drejta për të kërkuar këtë dëmshpërblim mund të zbatohet me vendim gjykate deri në përfundimin e një periudhe 2-mujore pas shkeljes së të drejtave.

6. Pikat nga 1 deri në 4 të këtij neni nuk zbatohen ne rastin kur një autoritet i pushtetit qendror ose vendor zotëron tituj të shoqërisë, objekt i ofertës, të cilët u japin të drejta të veçanta, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Neni 18

Zbatimi i reciprocitetit

1. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë, objekt i ofertës, e cila ka vendosur moszbatimin e nenit 15 të këtij ligji, mund të vendosë që ky nen të zbatohet, nëse ofruesi ose shoqëria mëmë e ofruesit, në përputhje me nenin 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nuk i nënshtrohet dispozitave të barazvlefshme me nenin 16 të këtij ligji.

2. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë, objekt i ofertës, e cila ka vendosur për zbatimin e normës së kapërcimit të kufirit, të parashikuar në nenin 17 të këtij ligji, mund të vendosë për moszbatimin e kësaj norme, nëse ofruesi ose shoqëria mëmë e ofruesit, në përputhje me nenin 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nuk i nënshtrohet një norme të tillë.

3. Administrata e shoqërisë, objekt i ofertës, njofton menjëherë Autoritetin për vendimin e asamblesë së përgjithshme, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni. Vendimi publikohet menjëherë edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare, objekt i ofertës.

Neni 19
Ndryshimi i ofertës

1. Ofruesi, deri në një ditë pune përpara përfundimit të afatit të lejuar për pranimin e ofertës, mundet:

- a) të rrisë çmimin;
- b) të ofrojë një çmim alternativ, me vlerë të barabartë;
- c) të zvogëlojë sasinë minimale të aksioneve ose të drejtave të votës, të cilat duhen marrë për ta quajtur të suksesshme ofertën për marrje në kontroll;
- ç) të revokojë ndonjë kusht, nëse ka.

2. Ndryshimet e ofertës për marrje në kontroll njoftohen menjëherë, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji e nëse ky publikim bëhet brenda 8 ditëve pune përpara përfundimit të afatit të lejuar për pranimin e ofertës, afati i pranimit të ofertës së ndryshuar shtohet me, të paktën, 8 ditë pune pas datës së këtij publikimi.

3. Aksionarët, që e kanë pranuar ofertën përpara çastit të ndryshimit të saj, mund të tërhiqen nga kontrata deri në mbarimin e afatit të lejuar për pranimin.

Neni 20
Ofertat konkurruese

1. Oferta konkurruese për marrje në kontroll janë ofertat e bëra nga të tretët gjatë kohës së lejuar për pranimin e ofertës për marrjen në kontroll. Çdo person ka të drejtë të bëjë një ofertë tjetër për të marrë në kontroll, brenda ditës së 15-të, pas përfundimit të periudhës, brenda së cilës duhet të bëhet deklarata e pranimit.

2. Oferta konkurruese publikohet dhe miratohet nga Autoriteti, nëse për aksionarët është më e favorshme se oferta për marrjen në kontroll apo se një ofertë tjetër e mëparshme konkurruese. Një ofertë konkurruese vlerësohet si më e favorshme, nëse çmimi i përcaktuar me mjete monetare është, të paktën, 5 për qind më i lartë. Nëse jepet një tjetër ofertë konkurruese, ajo vlerësohet më e favorshme, nëse çmimi i saj, i përcaktuar në mjete monetare, është, të paktën, 5 për qind më i lartë se çmimi i ofertës së mëparshme konkurruese. Nëse një ofertë e re konkurruese ndryshon nga oferta e mëparshme konkurruese vetëm në lidhje me çmimin e përcaktuar, Autoriteti vendos për miratimin e saj brenda 3 ditëve pune.

3. Kur oferta konkurruese miratohet dhe publikohet në përputhje me rregullat e përgjithshme, oferta e mëparshme dhe deklarata e pranimit e saj vlerësohen të pavlefshme.

Neni 21
Transaksione me titujt e shoqërisë, objekt i ofertës

Pas publikimit të dokumentit të ofertës, ofruesi dhe shoqëria, objekt i ofertës, së bashku me personat që veprojnë në bashkëpunim me to, njoftojnë menjëherë Autoritetin dhe publikojnë, në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, të dhënat për çdo shitje ose marrje në zotërim të titujve të shoqërisë, objekt i ofertës.

Neni 22
Publikimi i rezultatit të ofertës

1. Ofruesi, pas mbarimit të kohës së lejuar për pranimin, publikon rezultatit e ofertës, në përputhje me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Shoqëria aksionare, pavarësisht detyrimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, regjistron kalimin e aksioneve në regjistrin e aksioneve të shoqërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në regjistrin e titujve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 23

Ndalimi i ofertave të mëpasshme

1. Në rast të mbylljes pa sukses të një oferte, ofruesi dhe personat, që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk mund të bëjnë një ofertë tjetër për titujt e shoqërisë, objekt i ofertës, brenda 1 një viti nga publikimi i rezultatit të ofertës.

2. Oferta vlerësohet e pasuksesshme nëse:

- a) Autoriteti nuk e ka miratuar;
- b) Autoriteti e ka ndaluar;
- c) nuk është realizuar ndonjë nga kushtet e vendosura nga ofruesi, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Neni 24

Pagesat e paligjshme

Ofruesi ose personat, që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk duhet të japin apo të premtojnë pagesa a përparësi për administratën e shoqërisë, objekt i ofertës, nëse këto nuk janë parashikuar në përmbajtjen e dokumentit të ofertës.

Neni 25

E drejta për të kontrolluar gjithë shoqërinë

1. Ofruesi, i cili, në kuadër të një oferte për marrje në kontroll, ka marrë të paktën 90 për qind të kapitalit që mbart të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, duhet që, brenda 3 muajve nga mbarimi i afatit të lejuar për pranimin e ofertës, t'u kërkojë zotëruesve të aksioneve të mbetura me të drejtë vote t'ia shesin atij këto aksione kundrejt një kundërvlere me kushte të barabarta, vetëm nëse në dokumentin e ofertës është parashikuar një qëllim i tillë i ofruesit, sipas shkronjës “h” të nenit 7 të këtij ligji. Nëse ofruesi zotëron 90 për qind të të gjitha aksioneve, që mbartin të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës të shoqërisë, objekt i ofertës, ai mund të kërkojë edhe blerjen e aksioneve të mbetura me përparësi dhe çdo aksion tjetër pa të drejtë vote, që i shiten atij.

2. Pagesa për aksionet që kërkohen të merren, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në të njëjtën formë si pagesa e ofruar në ofertën për të marrë në kontroll dhe vlera është ajo e caktuar në një ofertë për marrjen në kontroll (ofertë vullnetare) ose vlera e kapitalit për çdo aksion, cila vlerë të jetë më e madhja.

Neni 26

E drejta e aksionarëve të vegjël për t'u larguar

1. Zotëruesit e aksioneve të mbetura me të drejtë vote kanë të drejtë që, brenda 3 muajve nga mbarimi i afatit të lejuar për pranimin e ofertës, t'i kërkojnë ofruesit të blejë aksionet, kundrejt çmimit të ofruar, në kuadër të ofertës për marrjen në kontroll, nëse ky ofrues ka marrë, të paktën, 90 për qind të kapitalit që mbart të drejta vote dhe 90 për qind të të drejtave të votës së shoqërisë, objekt i ofertës. Nëse ofruesi zotëron 90 për qind të të gjitha aksioneve, këtë të drejtë e gëzojnë edhe zotëruesit e aksioneve të mbetura me përparësi pa të drejtë dhe të gjitha aksionet e tjera pa të drejtë vote. Për formën dhe vlerën e pagesës, në këtë rast, zbatohet rregulli i parashikuar në pikën 2 të nenit 25 të këtij ligji.

2. Kur, si rezultat i një oferte për marrje në kontroll, ofruesi merr 90 për qind të aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, nuk zbatohen parashikimet e nenit 212 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 27

Ofertat vullnetare të pjesshme

1. Për ofertat vullnetare të pjesshme, të cilat kanë për qëllim marrjen në zotërim të një pjese të aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, që nuk arrin kufirin e kontrollit, zbatohen nenet 6 deri në 14 dhe 19 deri në 24 të këtij ligji.

2. Nëse aksionarët, që pranojnë ofertën, përfaqësojnë më shumë aksione se ato që kishte si synim të blinte ofruesi, ata duhet të trajtohen në mënyrë përpjesëtimore.

KREU III

OFERTAT E DETYRUESHME

Neni 28

Detyrimi për të bërë një ofertë dhe për ta publikuar atë

1. Kur ofruesi, vetë ose së bashku me persona, që veprojnë në bashkëpunim me të, merr në zotërim tituj të shoqërisë, objekt i ofertës, të cilët, nëse mblidhen me titujt, që zotëronin para ofertës, i japin atij një përqindje të drejtash vote, të cilat i mundësojnë kontrollin mbi shoqërinë në fjalë, ofruesi, brenda 7 ditëve, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, njofton dhe publikon këtë fakt, si dhe, në mënyrë të saktë, të drejtat e votës që zotëron. Afati i mësipërm fillon nga dita kur ofruesi vihet në dijeni ose, në bazë të rrethanave, duhet të ishte në dijeni për fitimin e kontrollit mbi shoqërinë, objekt i ofertës.

2. Brenda 10 ditëve nga data e publikimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesi i paraqet për miratim Autoritetit një dokument oferte dhe e publikon atë në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji.

3. Oferta u drejtohet të gjithë zotëruesve të mbetur të titujve për të gjithë titujt që zotërojnë.

4. Kur kontrolli është ndërmarrë në bazë të një oferte vullnetare, të publikuar në përputhje me nenin 7 të këtij ligji dhe drejtuar të gjithë zotëruesve të titujve për të gjithë titujt që zotërojnë, detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, për publikimin e ofertës, nuk zbatohet.

5. Të drejtat, që rrjedhin prej aksioneve të zotëruara nga ofruesi ose nga personat që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk mund të ushtrohen, nëse nuk janë përmbushur kërkesat e pikave 1, 2 e 3 të këtij neni.

6. Dispozitat e kreut II të këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të bëra në nenet 11 pika 1, 23 e 27 të tij, zbatohen edhe për kreun III, nëse në to nuk parashikohet ndryshe.

Neni 29

Përjashtime nga detyrimi për të bërë ofertë

1. Nëse si rezultat i blerjes se aksioneve të shoqërisë, objekt i ofertës, ofruesi apo personat, që veprojnë në bashkëpunim me të, nuk marrin kontrollin e shoqërisë dhe nuk ndryshon personi që ka kontrollin e shoqërisë, objekt i ofertës, atëherë ofruesi nuk ka detyrim për të bërë një ofertë, por duhet të njoftojë Autoritetin brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 28 të këtij ligji.

2. Pavarësisht se nuk është e detyrueshme të bëhet ofertë, Autoriteti duhet të njoftohet brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 28 të këtij ligji edhe në rastet kur:

a) një aksionar tjetër ose persona, që veprojnë në bashkëpunim me të, zotërojnë, të paktën, të njëjtën sasi të drejtash vote të shoqërisë, objekt i ofertës, me ofruesin;

b) përqindja e aksioneve që japin kontrollin kalohet vetëm përkohësisht ose pa paramendim dhe ulet menjëherë sapo ofruesi të vihet në dijeni të këtij fakti;

c) aksionet janë marrë përmes dhurimit, trashëgimisë apo ndarjes së pasurisë;

ç) aksionet janë marrë për ristrukturim, nëse shoqëria, objekt i ofertës, është në krizë ose nëse një grup shoqërisht është në krizë, sipas neneve 206 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

3. Autoriteti, brenda 10 ditëve nga marrja e informacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, mund t'i kërkojë ofruesit të bëjë një ofertë, nëse, për shkak të rrethanave të rastit, e vlerëson të nevojshme ofertën për të ruajtur interesat e shoqërisë, objekt i ofertës, apo të aksionarëve të saj.

4. Nuk zbatohet detyrimi për të bërë një ofertë për operationet e riorganizimit të parashikuar në nenet 214 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU IV DISPOZITA PROCEDURALE

Neni 30

Kompetenca e Autoritetit dhe bordit të tij

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është përgjegjës për:

a) mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, në përputhje me objektivat e parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare";

b) marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e të metave, që mund të lindin gjatë procedurës së ofertës për marrjen në kontroll.

2. Autoriteti miraton rregulloret e nevojshme, në zbatim të këtij ligji.

Neni 31

E drejta për ankim

Vendimet e Autoritetit janë objekt ankimi në gjykatë. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimeve të marra nga Autoriteti në zbatim të këtij ligji.

Neni 32

Bashkëpunimi ndërkombëtar i autoriteteve

1. Autoriteti krijon marrëdhënie ose hyn në marrëveshje mirëkuptimi me çdo autoritet mbikëqyrës, vendas apo të huaj, me mbikëqyrës të sektorit financiar, agjenci kundër pastrimit të parave apo çdo institucion tjetër, për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe shkëmben informacion me këto autoritete, sa herë e shih të nevojshme, për arsye të përmbushjes së funksioneve të përcaktuara nga dispozitat e këtij ligji.

2. Bashkëpunimi përfshin të drejtën për të dhënë dokumentet ligjore të nevojshme për vënien në zbatim të masave të marra nga autoritetet kompetente për ofertat, si edhe ndihmën në fusha të tjera, sipas kërkesës së autoriteteve mbikëqyrëse, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara nga Autoriteti.

KREU V SANKSIONET

Neni 33

Pezullimi i të drejtave

Të drejtat e aksioneve, që zotërohen nga ofruesi ose personat, të cilët veprojnë në bashkëpunim me të, nuk mund të ushtrohen për sa kohë nuk përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 28 të këtij ligji.

Neni 34
Kundërvajtje administrative

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia:

a) mospublikimi ose dhënia e informacionit apo mospublikimi ose dhënia e informacionit të pasaktë e të paplotë e jo brenda afatit, në përputhje me:

- i) nenet 6 pikat 1 e 2, 7 pika 3, 28 pikat 1 e 2 e 29 të këtij ligji;
- ii) nenet 12 pikat 2 e 3, 14 pika 3, 19 pika 2, 21 e 22 pika 1 të këtij ligji;
- iii) nenet 6 pika 3, 7 pika 4 e 14 pika 2 të këtij ligji;
- iv) nenet 16 pika 3, 17 pika 3 e 18 pika 3 të këtij ligji;
- v) pikën 2 të nenit 36 të këtij ligji;

b) mosparaqitja e një dokumenti oferte, sipas kërkesave të pikave 1 e 2 të nenit 1 të këtij ligji, ose paraqitja e pasaktë, e paplotë ose jashtë afati e këtij dokumenti;

c) publikimi i ofertës, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji;

ç) veprimi në kundërshtim me nenin 15 ose 16 pika 2 shkronja “a” të këtij ligji;

d) bërja e një oferte në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji;

dh) premtimi i avantazheve, pa i bërë të ditura ato, sipas parashikimeve të nenit 24 të këtij ligji;

e) ushtrimi i së drejtës për të larguar aksionarët e vegjël nga shoqëria pa e bërë të ditur, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 26 të këtij ligji.

2. Autoriteti zbaton sanksionet e mëposhtme:

a) shkeljet e parashikuara në shkronjat “a” nënndarjet “i” e “iii”, “b”, “c”, “ç”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë nga 5 000 000 (pesë milionë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

b) shkeljet e parashikuara në nënndarjet “ii”, “iv” e “v” të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë nga 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

KREU VI
VLEFSHMËRIA NDËRKOMBËTARE

Neni 35
**Shoqëritë aksionare të regjistruara në Shqipëri dhe të listuara
në bursë jashtë Shqipërisë**

Nëse aksionet me të drejtë vote të një shoqërie, objekt i ofertës, nuk janë listuar në tregun e organizuar të Shqipërisë, por në tregun e organizuar të një shteti tjetër anëtar të BE-së ose të një shteti të zonës ekonomike europiane, për ofertat vullnetare dhe të detyrueshme zbatohen vetëm dispozitat në vijim të këtij ligji:

a) nenet 6 pika 3, 7 pika 4 dhe 14 pika 2, për njoftimin e punëmarrësit e shoqërisë, objekt i ofertës;

b) shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 2, për përkufizimin e kontrollit;

c) neni 15 për veprimet mbrojtëse, që kryen administrata e shoqërisë, objekt i ofertës;

ç) nenet nga 16 deri në 18, për kufizimet me zgjedhje për veprimet mbrojtëse;

d) neni 28, për detyrimin për të bërë një ofertë;

dh) neni 29, për përjashtimet nga bërja e një oferte;

e) çdo dispozitë tjetër e ligjit për shoqëritë tregtare, në të cilën referon ky ligj.

Neni 36

**Shoqëritë aksionare të regjistruara jashtë Shqipërisë
dhe të listuara në bursë në Shqipëri**

1. Nëse shoqëria, objekt i ofertës, e ka selinë në një shtet tjetër anëtar të BE-së ose të zonës ekonomike europiane, zbatohen dispozitat e këtij ligji, për përmbajtjen dhe procedurën e ofertave, konkretisht dispozitat e krerëve I, IV e V dhe nenet nga 5 deri në 29 të këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të nenit 35 të këtij ligji, si dhe dispozitat e tjera të ligjit për shoqëritë tregtare, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) aksionet me të drejtë vote pranohen vetëm në tregun e organizuar në Shqipëri;

b) aksionet me të drejtë vote pranohen në tregun e organizuar në Shqipëri dhe në një shtet tjetër, por jo në shtetin ku ka selinë shoqëria, objekt i ofertës dhe:

i) pranimi i parë në tregun e organizuar ka ndodhur në Shqipëri;

ii) pranimet në tregjet e organizuara kanë ndodhur njëkohësisht dhe shoqëria, objekt i ofertës, ka zgjedhur Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, si autoritetin kompetent.

2. Një shoqëri, objekt i ofertës, aksionet me të drejtë vote të së cilës janë pranuar njëkohësisht për tregtim në tregjet e organizuara në Shqipëri dhe në një shtet tjetër, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, por jo në shtetin ku ka selinë, vendos vetë se cili prej autoriteteve përkatëse për mbikëqyrjen e një oferte mund të jetë autoriteti kompetent. Shoqëria, objekt i ofertës, e bën të ditur këtë vendim, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 6 të këtij ligji, ditën e parë të tregtimit të aksioneve të veta në tregun e organizuar në Shqipëri.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 37

Zbatimi

1. Ky ligj zbatohet për ofertat vullnetare të bëra pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Ky ligj zbatohet për ofertat e detyrueshme, nëse ngjarja, që sjell lindjen e detyrimit për të bërë ofertën, sipas pikës 1 të nenit 28 të këtij ligji, ndodh pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6457, datë 9.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 16.3.2010

Doli nga shtypi më 18.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë